

INTERVISTË ME ADEM VOKSHIN

Prishtinë | Data: 6 tetor, 2021

Kohëzgjatja: 113 minuta

Të pranishëm:

1. Adem Vokshi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotri Adem, nëse mundeni me u prezantu, me jep një biografi të shkurtë për juve, pastaj për familjen diçka, prejardhjen?

Adem Vokshi: Po e nderuar, unë jam Adem Vokshi. Jam i lindur me 18 janar 1952, në qytetin e Pejës, në Lagjen e Kapeshticës (buzëqeshë), ashtu qysh njifet. Dhe familja ime ka prejardhje prej fshatit Pobergj të komunës së Junikut, por shumë vite ma herët, para se me lindë baba edhe babëgjyshi edhe stërgjyshi janë shpërngulë në Pejë. Atëherë, Peja ka qenë një qytezë e vogël kur unë kom qenë fëmi. Baba im quhet Osman, Osman Vokshi. Ka qenë i lindur në vitin 1924 dhe po... Nana ime e lindur me 1931, po ashtu nga Peja. Babën e ka pasë hoxhë në atë kohë dhe ata janë martu në vitin '50 më duket edhe para meje ju ka lindë një vajzë e cila është qujtë Emetullah, por ajo ka vdek para se me le unë në '52-tën.

Mandej unë jam djali i parë i asaj familjes edhe pas meje ka lindë edhe një vëlla në '55-tën. Mandej ka lindë një motër '58-tën. Në '68-tën m'ka lindë një vëlla që tash është patolog në spitalin e Pejës punon dhe një motër e cila është farmacistë në Pejë punon. Kjo është familja ime ma e ngushta. Ndërkohë, unë...

Anita Susuri: A mundeni me spjegu qatë shpinë e parë të jujën qysh e kujtoni? Qatë lagjen?

Adem Vokshi: Shpia e parë e imja unë ku kom le dhe ku kanë jetu prindërit e mi ka qenë në Kapeshticë, Rruga "Mustafa Bakija", numër 52, e mbaj në mend mirë. Ka qenë shtëpi dy katëshe. Kati poshtë ka qenë, unë nuk e mbaj në mend, por me siguri kanë mbajtë kafshët aty se i thojshin, një pjesë ahër ashtu, ku janë mbajtë kafshët... edhe kati nalt i ka pasë tri dhoma. Aty kanë jetu baba edhe dy axhallarët e mi. Një axhë ma i vjetër edhe një axhë ma i ri edhe secili prej tyre ka jetu në nga një dhomë edhe e kena pasë çardakun. Ashtu i thojshim çardakun, ajo pjesa ku kena ndejt gjatë ditës, ku kena hangër bashkarisht mëngjesin, drekën edhe darkën.

Edhe secila prej dhomave e ka pasë, në popullorqe e qujshim, hamamxhikin, apo banjon ku jonë la njërezit atje edhe ajo ka qenë sikur një dollap tash që i mbajmë ato edhe ka qenë e mbulume me drrasa dhe nalt kanë qenë teshat (buzëqeshë). Edhe kur u shfrytëzu si banjo janë hekë ato teshat {përshkruan me duar} edhe uji i nxehtë u marrë atje, sepse në atë kohë nuk ka pasë banjo. Po aty kena jetu deri në vitin 1960. Kur baba im edhe axha i madh e kanë ble një shpi nga dyqind metra ma poshtë, poashtu në Kapeshnicë edhe ajo shpi ka qenë me një tetë ose dhetë dhoma, por secila dhomë e ka pasë nga një qiraxhi. Qiraxhi ka qenë e dhonme prej pronarëve me qesim¹ edhe meqenëse ata që kanë qenë qiraxhi nuk e kanë lëshu shtëpinë.

Ai pronari jetonte në Kralejë nëse nuk gabohem. Atëherë kam qenë shumë i vogël, tetë vjeçar, ka vendosë me shitë shtëpinë, por kërkush nuk e blente atë shtëpi me qiraxhi edhe baba im ka vendosë me axhën me ble. E kanë ble atë shtëpi edhe na dikund mas nga një vjetë një qiraxhi e ka lëshu një dhomë prej atyne se nga një dhomë kanë jetu ata edhe mandej na jena dal vetëm na familja. Baba jem me nanën edhe ne fëmijët kena dalë aty edhe mbas nga tre-katër muje e ka lëshu edhe një qiraxhi edhe një qiraxhi. Mbas nga dy-tri vjetë ka qenë ajo shtëpi e lirë edhe mbas një kohe ka ardhë edhe axha i madh atje me jetu edhe e kena nda atë shtëpi përgjysë. Gjysmën e ka shfrytëzu axha, gjysmën e kena shfrytëzu na.

Ka qenë dikund nga pesë ari atje. Ajo shtëpi ende ekziston me atë ndryshim. Në vitin 1979 vërshimet kur kanë qenë në Pejë, meqenëse ka qenë shtëpi prej qerpiçëve e mbarume, ju e dini çka jonë qerpiçët? [i drejtohet intervistuesës] Vërshime e kanë mbulu dikund nga një metër e gjysë ujë e ka mbulu atë shtëpinë edhe prej Kuvendit Komunal u shpallë si shtëpi që nuk mundet me u banu. Dhe mandej na kanë dhonë lejen edhe në '81-tën kena fillu me mbaru shtëpinë e re edhe qajo shtëpi e re osht' renovu pas vitit '99, sepse u kallë prej forcave serbe gjatë vitit '99. Osht' renovu edhe ekziston ende ajo shtëpi në Pejë.

Anita Susuri: Si e kujtoni kohën kur keni fillu në shkollë? A ka qenë larg shkolla? A ka qenë afër?

Adem Vokshi: Shkollën e kom pasë larg, ndoshta nga 15 minuta si fëmijë, por ka qenë një gëzim shumë i madh kur jam regjistru në shkollë. Mësuesen e parë e kom pasë, si sot e mbaj mend Shadije Kotori ka qenë. Ajo është e ndjerë tani, edhe sikur çdo fëmijë tjetër edhe unë s'kom dashtë kërkund tjetër përveç asaj mësueses. Kom mendu se është njeriu ma i mirë në botë (buzëqeshë) edhe në të vërtetë ka qenë një grup e mbrekullueshme. Më kujtohet shumë mirë kur vijsha prej shkollës edhe na jepshin detyrat edhe unë vijsha t'u qajt. M'vetke nana, "Çka ki?" "Kom detyra me bo". Edhe as bukë nuk hajsha as kurgjo m'u ulë me i kry detyrat {përshkruan me duar} që i kisha të shtëpisë edhe më ndihmojke nana ime.

¹ Pa e peshuar ose pa e matur, duke i caktuar një çmim të përgjithshëm. P.sh. E dha qesim. E bleu qesim. E mori qesim.

Nana ime i ka pasë vetëm katër klasë të shkollës fillore. Aq ka pasë edhe baba im. Por [ajo] ka ditë me më mësu atëherë sepse bashkë me mu u mësu edhe ajo (qeshë), por ma lehtë i ka kuptu edhe i kom kry ato detyrat. Në shkollë, deri në klasën e pestë e mbaj në mend e kom pasë një mësuese atëherë ose arsimtar, se prej klasës të pestë jonë qujtë arsimtar. Ai më ka dhonë gjuhë shqipe edhe në atë kohë unë e kom pasë dajën ushtar edhe letrat e dajës unë i shkrujsha. Po, për familjen i shkrujsha. Daja ka qenë ushtar në Zagreb...

Edhe na ka dhonë një detyrë letër një shokut edhe unë e kom bo atë detyrën. Është një digresion për shkrimin që e kom sot {përshkruan me duar}, e kom gati të pakuptushëm a din (buzëqeshë). Po jena msu me kompjuter me punu, por atëherë atë detyrën time me ushtrimore në krejt shkollën ku ka dhonë ai mësim, ai Mustaf Puqesta e ka shëtitë, çfarë shkrimi edhe çfarë përmbajtje. Ka qenë i mbrekullueshëm. Po livdohna pak, por ashtu ka qenë (qeshë). Edhe pse nuk e kom virtyt m'u livdu, por ja kjo ka qenë edhe unë e kom ndi vetën shumë, shumë mirë.

Në atë kohë më kujtohet kur ka qenë Dita e Rinisë, ditëlindja e shokut Tito, atëherë 25 maji na kanë çu në ndërtesën e Komitetit edhe mu më kanë zgjedh prej shkollës. Mu edhe nja dy nxanësa tjerë edhe të shkollave tjera edhe na kanë çu në atë ndërtesë. Atje ka qenë diçka e pamundun unë me hi si nxanës në ndërtesë të Komitetit (buzëqeshë) edhe na kanë dhonë do bombona në kесе të najllonit, do bombona, do qesi sene, a din si dhurata edhe unë me plot gëzim jom kthy në shtëpi çka kom bo.

Anita Susuri: A i keni pasë edhe ato shamijat e kuqe?

Adem Vokshi: Jo, jo, po na jepshin edhe ato shamijat (qeshë) po. Ka qenë, ka qenë ajo kohë shumë e mbrekullueshme. Peja ka qenë një qytezë, që thashë pare, shumë e vogël. Tani ku osht' policia edhe ndërtesa e gjykatës në Pejë, aty ka qenë ktyneherë i thojshim "Dulja" edhe në anën ka Gjakova andej, jo stadioni, ma nalt se stadioni ku osht' në Pejë atje edhe aty ka qenë "Dulja", i thojshin, dogana. Dilshin tagrambledhësit. Fshatarët kur vijshin në qytet me i shitë sendet me ja u marrë atë tatimin. Në qitë mënyrë u merrke tatimi. Domethonë, Peja qaq ka qenë. Tash Peja osht', osht' rritë shumë, shumë.

Anita Susuri: Po më intereson për prindërit e ju, nana, baba me çka janë marrë?

Adem Vokshi: Nana ime ka qenë amvise, ka qenë edhe pse e kanë lutë me dhonë mësim edhe me dy klasa e me katër klasë në fillore. Por jo, ajo ka dashtë m'u kujdesë për neve fëmijët, sikurse edhe shoqja jeme që kujdeset për fëmijët edhe pse e ka përfundu Fakultetin e Historisë. Baba im ka qenë zhgunaxhi. A e kuptoni zhgunaxhiun? [i drejtohet intervistuesës] Veshja kombëtare, me qato o marrë kur kom qenë unë i vogël. Mandej kur fillun zhgunat mos m'u përdorë shumë, po, atëherë fillun si rrobaqëpës me punu.

E di kur vinte koha e 25 majit, e festave, krejt shkollat organizonin nxanësat me shku në *slet*² atëherë i qujshin *slet* atëherë nëpër stadione. Edhe vyjke me i qepë bregët për mashkuj edhe baba me axhën, atëherë punojshin bashkë i kanë qepë qato. Edhe jonë marrë me qato deri në vitin '90.

Anita Susuri: A e ka pasë dyqanin ndoshta?

Adem Vokshi: Në çarshi të gatë po, po dyqanin e vet e kanë pasë.

Anita Susuri: A ju kujtohet dyqani qysh ka qenë? Ose qajo çarshia në atë kohë?

Adem Vokshi: Është shumë interesant, jo ai dyqan, por krejt dyqanet tjera kanë qenë shumë një pamje të zyrtë e kanë pasë. Nuk kanë pasë ku me ditë çfarë; në krahasim me dyqanet e sodit ato kanë qenë shumë të mbrapambetne. Nuk kanë pasë as tualet, nuk ka pasë edhe pse ka qenë dyqani me dy kate. Po ka qenë, ka qenë vobeksi [varfëri] shumë e madhe, shume e madhe ka qenë vobeksi edhe ajo ka qenë edhe arsyeja... Dyqani, çarshia e gatë që osht' e njofme e Pejës ka qenë me zallë e shtrume, nuk ka qenë as e asfalttume, as nuk ka pasë asi kocka ose kalldërm që i qujnë, ka qenë, ka qenë e tillë.

Anita Susuri: A i keni ndihmu edhe ju ndonjëherë babës në dyqan?

Adem Vokshi: Unë prej vogjlisë kom fillu me dalë në dyqan te baba edhe diku mbas, në vitet e '65 ose '66 daja im, njëni prej dajëve ka çelë dyqanin e pavarun të sahatçisë edhe mandej kom fillu me dalë te daja në dyqan sepse shumë më ka interesu profesioni i sahatave. Diçka çka mundesh kreativitetin me tregu në ato. Edhe kom punu aty deri i kom përfundu studimet.

Anita Susuri: Tash po du diçka me ju pyte se më la përshtypje për nanën që thatë që i ka përfundu katër klasa, e në atë kohë ka qenë diçka e jashtëzakonshme katër klasë m'i përfundu një femër. E çfarë familjes ka qenë ajo?

Adem Vokshi: Baba ka qenë hoxhë.

Anita Susuri: Po.

Adem Vokshi: Nonën e ka pasë shtëpiake edhe ajo, por baba ka qenë hoxhë edhe ka dhonë mësim në medrese, ka mbajt mësim, ka mbajt ligjerata edhe ai e ka dashtë shkollimin shumë. E ka dashtë shkollimin sa që njonin djalë, djalin ma të madh e ka shkollu edhe ai ka kry Akadaminë Ushtarake në atë kohë edhe po ka ndodh çka ka ndodh. Nuk ja kanë pëlqy një nuse që e ka zgjedh prej Pejës, por jo baba as nana, por gjyshja çka po di unë edhe ai, "A s'po doni këtë nuse? Po a? Ditën e mirë!" E ka shku

² Sleti ishte një manifestim sportiv vjetor, që përfshinte sportistë, nxënës, studentë, punëtorë dhe ushtarë të dalluar. Çdo vit, më 25 maj, mbaheshin sletet në qytete të ndryshme të Jugosllavisë për të shënuar Ditën e Rinisë dhe ditëlindjen e liderit të atëhershëm Josip Broz Tito.

ka jetu në Zagreb, atje e ka familjen. Nejse bashkëshortja i ka vdek, i ka fëmijët, në Zagreb i ka. Daja ma i madhi.

Daja i dytë, ai ka qenë sahatçi. Daja i vogël ka qenë edhe ai osht' marrë me sahata. Domethonë, ka qenë sahatçi por ka punu mandej në fabrikën e autopjesëve "Zastava". Në Pejë ka qenë si kuadër, kuadër deficitar në atë kohë i kanë marrë edhe pse me shkollë të mesme, por atëherë ka qenë ajo shumë, shumë e kërkume.

Anita Susuri: Me fol për vitet e '60-ta të jujat edhe fillimi i '70-tave ka qenë një periudhë tranzicioni për qytetet e Kosovës. Prej kasabave e qyteteve ka fillu, njëfarë ndëtimi ka fillu, por edhe në '74-tën me Kushtetutën domethonë.

Adem Vokshi: Ndryshimet Kushtetuese si kanë ndodh.

Anita Susuri: Ka ndodh njëfarë ndryshimi edhe politik edhe social. Qysh kanë qenë për juve qito vite?

Adem Vokshi: Unë nuk kom ditë me i përjetu ku me ditë sa këto vite. Mirëpo, viti '66 kur ka ra Rankoviç³ në atë kohë, ai ka qenë udhëheqësi i Shërbimit të Sigurimit Shtetënor të ish-Jugosllavisë edhe kanë bo zullume shumë të mdhaja. Mu më kujtohet kur tregonte baba kur kom qenë unë ma i vogël kur për çdo natë jo vetëm babën tim, por edhe njerëz të tjerë në Pejë i kanë marrë e i kanë çu në SUP⁴. Natën deri në mëngjes nuk i kanë lëshu tu i malltretu, besa edhe tu i likfidu i kanë çu në Tabje atje në Pejë edhe i kanë likfidu. Nuk u ditë kush çka po ndodh.

Thonte baba, "Unë e kom pasë fatin që kom pasë djem të hallës shumë edhe djem të tezës shumë edhe si m'kanë marrë mu, ata e kanë ditë kush m'ka marrë edhe gjithmonë jonë sillë rreth policisë," atje, a din, me tregu që na po e dijmë që na e kena këtu, "edhe qajo", tha, "m'ka pshtu. As me më malltretu, as me m'likfidu" tha. Gjë që ka qenë shumë rrezik në atë [kohë].

E kur ka ra Rankoviç ka ndrru krejt politika, ka ndrru edhe qëndrimi i serbëve që kanë udhëheqë kryesisht me qytetin e Pejës, me siguri edhe në qytete tjera. Ka ndryshy edhe ajo ndjenja e shqiptarëve mos me qenë mo inferiorë, a din. Por, me qenë të brabartë me popujt tjerë. Posaqërisht kur kanë ndodhë ndryshimet kushtetuese të vitit '74, kur me të vërtetë atëherë edhe unë si student e kom ndi veten shumë të knaqun se u bo edhe Kosova pjesë konstitutive e ish-Jugosllavisë atëherë, po.

Anita Susuri: Ju kur keni qenë n'shkollën e mesme, n'atë kohë edhe Peja pat' fillu nifare lulëzimi me pasë. Ka qenë ajo Karagaqi, ni park që është ndërtu edhe...

³ Aleksandar Ranković (1909-1983) ishte hero partizan serb, i cili u bë Ministër i Brendshëm dhe Kryesues i Inteligjencës Ushtarake i Jugosllavisë pas luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një regjim të terrorit në Kosovë, dhe e konsideronte atë si rrezik për Jugosllavinë. Në vitin 1966, ai u largua nga pozita e tij dhe u izolua në Dubrovnik deri në vdekjen e tij në vitin 1983.

⁴ Sekretarijat Unutrašnjih Poslova (SUP) - Sekretariati i Punëve të Brendshme.

Adem Vokshi: Po, po, po.

Anita Susuri: A mundeni pak për këtë me folë?

Adem Vokshi: Po është shumë i veçantë ai Karagaqi ose parku i madh se e kemi pasë edhe parkun e vogël te Komuna e Pejës. Po parku i madh ka qenë ni vendtakim. Ka qenë liqeni, ka qenë në mes të parkut të madh edhe parkun e madh gjithmonë e kanë rujtë dy roje. Rojet e kanë rujtë. Edhe parkun e vogël e kanë rujtë dy roje. M'kujtohen tash edhe emri i njëri prej atyre rojëve që kanë qenë atëherë, por nuk lejojnë me u gjujtë mbeturina, nuk lejojnë me kputë degtë. E rujshin edhe liqenin, e rujshin edhe liqenin. Aty kishte edhe peshqi kishte. Shumë shumë bukur ka qenë.

Aq bukur ka qenë sa që n'mëngjes kur u çojshim ne, si lindte dielli, si u zbardhke, shumica e studentave delshin atje për me mësu se ka qenë ni atmosferë e mrekullueshme. Delshin edhe t'rijtë për me shetitë, delshin edhe pleqtë për me shetitë. Ka pasë edhe karriga ku kanë mujtë me u ulë edhe me u fresku. Ka qenë ajri i mrekullueshëm, po atmosfera ka qenë shumë ma mirë. Mandej ka qenë, bash n'parkun Karagaq ka qenë ai lokali ku edhe pushimorja kanë qenë ku vishin turistë e hujë me kampshetpizë edhe u vendosshin aty. Ka pasë turista shumë edhe n'atë kohë Peja ka pasë.

Përveç Grykës së Rugovës që e kishte edhe atë bukurinë e kishte edhe t'qytetit atë bukurinë. Unë e mbaj n'mend kur, tani ku është Shtëpia e Mallnave në Pejë ka pasë dyqane n'atë anë ka pasë {shpjegon me duar} edhe dyqane n'këtë anë ka pasë. N'tana antë ka pasë dyqane atje. Me siguri mbi 300-400 dyqane kanë qenë. Tash krejt ajo është ledinë aty përveç Shtëpisë të Mallnave edhe biblioteka këtu që ka mbetë. Aty ka qenë bash pumpa e benzinit ku është, nëse e dini ku është Peja, përte pumpës t'benzinit ka qenë stacioni policor atëherë ka qenë kur jom kanë unë i vogël. Te Ura e Gurit, bash stacioni policor aty ku i kanë marrë shqiptartë edhe i kanë malltretu edhe i kanë përsekutu edhe krejt.

Anita Susuri: Qysh keni vendosë në atë drejtim me shku? Domethonë, n'shkollë të mesme ose me vazhdu shkollimin?

Adem Vokshi: Kur e kom kry shkollën fillore me insistimin e prindërve, unë atëherë s'kom ditë, kom qenë se a din {shpjegon me duar} po kom vazhdu shkollimin e mesëm. Edhe kur ka qenë me u orientu drejtimi shoqëror a shkencor, unë e kom marrë drejtimin shkencor se m'ka pëlqy ma shumë. E kom pasë djalin e hallës që ka shku në Shkollë Normale, po unë s'kom dashtë me shku në Normale se ka qenë pesë vjet, [ndërsa] ajo e gjimnazi ka qenë katër vjeçar edhe kam lakmu atë me kry.

Në vitin '68 kom qenë n'vitin e tretë gjimnaz, në të vërtetë n'vitin e katërt gjimnaz po m'duket, po, kur kom pasë problem me sy sepse m'lotojnë sytë shumë, edhe tani m'lotojnë. Edhe ka qenë në Pejë vishin mjekët e Mitrovicës edhe për oftamologt, domethonë mjekët e syve, edhe mjekët e veshit,

otolaringologë edhe për hund edhe për vesh. E vishin ni herë n'javitë me kontrollu në Pejë, se s'ka pasë Peja mjekë atëherë. Po edhe m'patën preferu me ardhë në Mitrovicë me bo operacion njanin sy.

Edhe unë pata ardhë edhe e pata bo për herë t'parë me e pa Mitrovicën. Mandej kom qenë edhe nihere po nuk e kom njoftë Mitrovicën fare. Kjo ishte ni përvojë shumë e mirë.

Korab Krasniqi: Qysh ka qenë për juve, m'fal që po kyçna kështu, me qenë se prej anës t'dajve janë marrë me zanat, po ashtu edhe baba është marrë me zanat. Në këtë rast e ke pasë si model nanën e cila ka qenë e bllokume n'shpi. Çka t'ka nxitë ty me e marrë drejtimin e edukimit, të shkollimit?

Adem Vokshi: Të tregoj ni sen. Prej fillimit kom pasë dëshirë shumë me lexu, nuk e di pse, po kom pasë dëshirë me lexu. N'dugojë te daja kur isha e kom pasë ni fqinj aty, ni shok t'mahallës aty i cili punonte në trafikë ku shiteshin, shtypi shitej. Edhe une u mërzitsha t'u punu n'dugojë, "Agim bre, a ki diçka me lexu?" A din, "Po more e kom kta". Ishin ato romanet e Niçes atëherë, po ishin serbisht, po unë edhe serbishten e njifsha. Prej shkollës t'mesme kom fillu me ble "Rilindjen", atëherë ishte "Rilindja", edhe kom fillu me ble "Politika Ekspres". Përveç kësaj unë e kom pasë axhën e madh, me t'cilin punojke baba, ai gjithmonë e ka ble "Politikën".

Atëherë ka qenë "Politika" një gazetë edhe e ka njoftë politikën në n'mënyrë të mrekullueshme edhe pse s'ka qenë političar, por e ka njoftë. Edhe ajo gjithmonë, kureshtja është bisedu për atë, është bisedu për këtë e pse edhe unë mos me ditë me u njoftu me këto. Ajo që kom lexu atëherë m'ka ndihmu që mos me pasë probleme me gjuhën serbo-kroate fare. Kur isha n'shkollën fillore, n'klasën e tretë fillore kom fillu me mësu gjuhën serbe atëherë. E kishim obligative edhe çirilicën edhe latinicën, bile ma shumë kishte çirilicë. Përveç asaj mu m'ka ndihmu edhe gjatë fakultetit edhe gjatë shkollës t'mesme se s'kishim libra atëherë t'gjuhës shqipe edhe merrshim libra serbisht.

Unë i merrsha librat serbisht me i konsultu. Në klasën e pestë fillore na kanë pru profesorin e rusishtës, nifarë Mirko Rashanin si sot e mbaj n'mend emrin, me msu edhe rusishten me msu. Na s'dojshim me msu rusisht dojshim anglisht, dojshim frangjisht, ata rusisht. E gjeneratat e tjera kanë msu do anglisht, do frangjisht, po neve e kom pasë fatin me msu rusisht. Edhe pse edhe rusisht e kam folë ni kohë shumë përfekt e kam folë. Bile në fakultet e kom pasë dhetshe në rusisht, se gjenerata jem e ka pasë edhe gjuhën e huj atëherë.

Anita Susuri: Thatë që n'vitin '68 operacion keni pasë n'sy...

Adem Vokshi: Po.

Anita Susuri: Po në '68-ën kanë qenë demonstratat...

Adem Vokshi: Po.

Anita Susuri: A keni marrë pjesë ju?

Adem Vokshi: Jo. Jo nuk kam marrë pjesë. Nxanës i shkollës t'mesme, ende s'kam qenë i...

Anita Susuri: A ju kujtohet qajo?

Adem Vokshi: Ende s'kam qenë i pjekur politikisht (qeshë).

Anita Susuri: Po. A ju kujtohen qyteti ose...?

Adem Vokshi: Jo, nuk i mbaj mend, nuk i mbaj mend ato.

Anita Susuri: Pas operacionit, keni vazhdu sigurisht?

Adem Vokshi: Po, gjimnazin, e kom përfunduar gjimnazin edhe mandej kom konkuru me u regjistru në Fakultetin e Mjekësisë se m'ka interesu mjekësia. Edhe u pranoshin gjenerata e dytë në Mjekësi. Ishte 90 kandidatë. Prej atyre 90 kandidatëve, unë ngela rezerva e 13-të, numër baksuz (qeshë). Prit mos nuk regjistrohet dikush e të regjistrohem edhe unë. Nejse, mandej jo regjistroje ni vit Biologji e kur e kryen Biologjinë mandej vjen vitin e dytë mjekësi. Edhe unë e regjistrova Biologjinë edhe, po... e kryva Biologjinë edhe Biologjinë e kryva, veç vitin e parë. Mandej kur shkova me u regjistru në Mjekësi, m'tha, "Jo, prej fillimit duhet se nuk bon ashtu", "Prej fillimit?" "Po", "Faleminerës, nuk jom i interesum". Edhe e lash.

Edhe t'u u kthy po e takoj babën diku afër menzës së studentave, atëherë ktu nelt {shpjegon me duar} ka qenë menza e studentave, te Fakulteti Juridik atje ka qenë. Edhe po e takoj babën, kishte ardhë e kishte pasë ni shok ktu, Jonuz Gulinikun, bash ku ka qenë Fakulteti Teknik. Përpara ma poshtë ka qenë ni pilarhone, ai shkonte aty. E t'u shku, "Hë çka bone?" "Kurgjo, qishtu qishtu..." "Ani?" "S'du me shku në fakultet hiç". "Çka u bo?" Tha. "Qishtu ma kanë bo", i dëshprum. Fati im po takohem me Sami Pejën, profesorin Sami Peja, edhe me Hajrulla Goranin. Ata dy shokë t'mirë, t'ngushtë t'babës.

Edhe, "Ha Osë, si je?" T'u bo muhabet ata. Osman baba jem emrin, Osë po e thirrni ata, shoqnia e kanë thirrë ashtu. "Valla qe, erdha te Jonuzi", te shoku i vet. Edhe Jonuzi ka qenë ni shok i tina i cili është malltretu shumë nëpër burgje. Edhe thotë, "Erdha te ky edhe u takova me djaln", "Ani, qysh i ki hallet ti? Çka po studion?" Thashë, "Valla, qishtu qishtu..." po ju tregoj. Edhe atëherë s'kishte konkursa t'hamamit po, "Ec", më tha, "ndaq juridik, ndaq ekonomik. Regjistro njanën", tha, "pa fakultet mos rri". Bon, s'bon, bon, s'bon edhe hajde e regjistrova. Juridikun e regjistrova t'u iu falënderu atyne dyve.

Mandej nuk kom ditë që Sami Peja ka me m'u bo baxhanak, po nejse (qeshë). Edhe e kom regjistru Fakultetin Juridik edhe e kom pasë regjistru, po jo ku me ditë me çfarë entuziasmi. Regjistro ni fakultet

që s'din as çka ki me u bo. Nuk kisha as paraftyrime se do t'bohna jurist nesër, do t'bohna avokat, gjykatës e krejt ato, a din. Po hajde me kry ni fakultet, mos me mbetë pa fakultet sepse kjo ishte vullneti i familjes ë? E unë e hupa atë vullnetin se kisha qef me u bo doktor. Kujtojsha që është ma mirë, po s'e kom ditë që s'osht' (qeshë).

Anita Susuri: A u vendosët pastaj në Prishtinë me banu?

Adem Vokshi: Po, u vendosa mandej në Prishtinë. Kom banu nja tre-katër muj ni vend, nja dy-tre muj ni vend. Po, se s'kishte mundësi me u vendos në konvikt. Kishte numër pak të konviktëve, kërkesat shumë t'mdhaja edhe udhëtojshim, udhëtojshim.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Prishtina n'atë kohë?

Adem Vokshi: Prishtina ka qenë... ni kohë kom banu në Breg të Dillit, tani OSCE është qatje nalt atje, edhe prej ktuhit i veshim çizmet me shku deri te furra. Ka qenë ni furrë mrapa Hotel Bozhurit, tash Swiss Diamond që osht', te Bozhuri ka qenë. Eh, aty ka qenë ni furrë. E unë me atë furraxhinë u njifsha, kisha pak muhabet me to, i lejsha qizmet aty edhe i veshim kpucat për me dalë n'korzë me shitë mend ngat femnave. Kshtu ishte. Ishte me t'vërtetë shumë vështirë.

E përveç asaj ishte edhe ma vështirë se deri në vitin e tretë të studimeve ne është dashtë me tren me udhëtu për Pejë. Treni prej Pejës në Fushë Kosovë na bijke mandej hypshim në autobus edhe vijshim në Prishtinë. Nuk kishte tjetër. Ose me shku ka Prizreni me autobus me ardhë kha ose kah Mitrovica. Drejt nuk ka pasë udhëtim. E mandej n'vitin e tretë të studimeve dikur u çelë rruga, me do ndërprerje po u çelë rruga edhe udhëtojshim ma lehtë.

Anita Susuri: N'cilin vit po i bjen që ju keni diplomu?

Adem Vokshi: '71-tën.

Anita Susuri: '71-tën. Qysh ka vazhdu tani? Qysh jeni organizu? Qysh jeni... po mendoj a keni vazhdu me jetu këtu në Prishtinë? A...

Adem Vokshi: Jo, une mbasi e kryva fakultetin, ka qenë Rizah Loci, kryetar i Gjykatës të Qarkut në Pejë edhe baba është njoftë me atë edhe u taku ni ditë me të. T'u bisedu, ai e ka ditë që po studioj unë juridikun, "Çka boni bre Ademi?" "Valla ai", thotë, "me 11 nandor e ka provimin e fundit". Thotë, "Kqyre, si ta kryen provimin e fundit le t'vjen te une n'zyre m'u lajmëru". Edhe unë pername me 11 nandor '75-tën e kryva provimin e fundit edhe shkova u lajmërova te ai. Tha, "Prej të parit je n'punë ktu në Gjykatë të Qarkut. Praktikant".

Edhe kom ndejtë në Gjykatë të Qarkut praktikant prej 1 dhjetorit '75 deri diku në shkurt të vitit '77. Në shkurt të vitit '77 e kom dhanë provimin e jurikadurës edhe kur kom ardhë t'nesërmen n'punë, m'ka thirrë kryetari, ky Riza Loci që e përmenda, edhe, "Çka bane me provim?" Thashë, "E dhashë". Tha, "Prej sotit je bashkëpunëtor profesional", "Faleminerës!" Mirëpo, unë kom punu shumë, shumë kom punu. Beso, jo për lavdatë po m'ka interesu puna. Jom msu me punu edhe privat, jom msu me punu mos me ndejtë kot e kot edhe ata m'kanë çmu shumë. Edhe kom punu deri në dhjetor të '77 aty, mandej prej janar '78-ës kom kalu në Gjykatë të Qarkut në Mitrovicë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: N'këtë periudhë, domethonë, prej '78, '80, sidomos '81 ka qenë ni situatë e vështirë politike...

Adem Vokshi: Po.

Anita Susuri: Edhe e komplikume. Po më intereson këndvështrimi i juj domethonë, si avokat, me çfarë raste jeni ballafaqu? Kond e keni mbrojtë apo diçka kështu?

Adem Vokshi: Po, po. Fillimisht spjegohet se pse shkova në Mitrovicë. Është shumë interesant. Nji ditë, i ndjeri, Mikel Marku në Pejë ka qenë avokat, ka qenë edhe kryetar i Odës të Avokatëve. Donte me shku në Mitrovicë, të nesërmen kishte gjykim në Mitrovicë. Edhe unë punojsha në atë kohë n'zyre të Ferid Gjickollit, tash është avokat në Pejë. Ai ka qenë gjykatës, unë bashkëpunëtor profesional. Edhe po i thotë, "Ferid, hajde bre bonëm shoqni", thotë, "Nuk muj se kom gjykime. Pse s'pe merr Ademin?" Edhe une p'i kqyri, "Po unë kom me punu". "Le", tha, "ato punë", se gjykime s'kisha po punojsha ktu... tha, "Le ato i punon kur kthehesh. Dil në Mitrovicë".

Edhe shkova në Mitrovicë me Mikel Markun edhe po e mbajnë gjykimin. Po e kqyri unë atë gjykatësin, haj mozamaq, s'din me mbajtë gjykim, s'din a! P'i thom, "Mikel, a qishtu janë a?" Tha, "Çka m'i bo?" Shqiptar ai gjykatësi, nejse. Edhe kur dulëm n'pauzë e lypi Kapllan Barutin, kryeprokurorin e Mitrovicës atje, po s'e gjeti aty se ishte političar edhe ai me politikë atje. Edhe shkum te kryetari i gjyqit me pi kafe derisa t'kalon pauza. Edhe aty t'u bisedu edhe po tregon Mikeli qysh po m'lavdojnë mu kolegtë në Pejë, çfarë punëtori i hatashëm jam e qashtu e qashtu.

I kryjsha unë edhe dy edhe tri norma s'e kisha gajle, veç a ka punë me kry. Bile e kena pru gjendjen në Gjyq të Qarkut në Pejë n'atë kohë në zero-zero, si t'mrrin landa me e kry. Qaq ka qenë azhuriteti i madh, i mrekullueshëm. Edhe ma bon kryetari, tha, "A vjen te une me punu bashkëpunëtor profesional?" Thashë, "Pse a jom i krisur unë a? Bashkëpunëtor rri në Pejë, jo ktu". "Ani a kishe ardhë gjykatës?" Thashë, "Jo, more çfartë". Tha, "Jo, me ardhë gjykatës te une ta sigurojmë ni banesë dy

dhomëshe, ta sigurojmë ni femën t'martojmë me të", qisi sene, qysh bisedojnë mashkujt. Edhe jo, jo, jo.

Po mbas nja dy mujve kur po vjen delegacioni prej Prishtinës atje me m'bind mu për me kalu në Mitrovicë, edhe unë kurrsesi s'po jap pëlqimin. Ishte i ndjeri Xhevdet Hamza, ka qenë kryetar i komisionit për zgjedhjen e kuadrave edhe mbas nja dy orë që u mundu me m'bind tha, "A din çka? Ti pyte babën tond", tha, "vete atë, nëse thotë ai jo, mos e..." Edhe kur shkova n'shpi, ai po m'sheh baba, "Çka ki?" Thashë qishtu qishtu, "S'ki qare pa shku". Unë po pres përkrahje prej tij. "S'ki qare pa shku". "Pse?" Thashë, "Abej". Abej e thirrsha.

"Oh", tha, "nuk je as inxhinier, nuk je as doktor", tha, "je jurist". Tha, "Perspektiva jote është e dekne nëse nuk i ndigon". U kry. Edhe kështu kom shku në Mitrovicë. Edhe në Mitrovicë kur kom fillu punën ka qenë shumë interesant. Kryetari i gjyqit po m'i jep veç landtë e shkallës dytë, qato çka kisha punu në Pejë. Edhe unë shkova, thashë, "Kryetar, në qoftëse i ke ra pishmon që m'ke pru ktu une kthehna, nuk ka nevojë". Thashë, "Unë si s'i marrë edhe landtë e shkallës parë me gjyku", thashë, "unë s'jam gjykatës". "Ani, ani, veç masi unë jam ktu".

Edhe n'atë kohë në '75-tën, po gjyqi ish formu, po '75-tën ose '74-tën ishte formu në Mitrovicë. Krejt landtë e Prishtinës që kanë qenë të territorit të Mitrovicës edhe para '70-tës që janë inicu procedurat kanë mbetë. I kanë lanë gjykatësat, "Hajt se po çelet në Mitrovicë edhe shkojnë atje". E kur shkova unë ishin nja 360 landë bajagi t'mdhaja me i nda n'mes meje edhe dy gjykatësve, ishte edhe një serbe gjykatëse edhe një serb gjykatës. Edhe i ndamë nga 120 landë, edhe unë kur i mora ato landë... edhe nuk m'frikësojshin landtë fare, a din, kur don me punu njeri. Edhe i mora, edhe meniherë i caktova ato landë.

Mbas nja gjashtë-shtatë muje po m'vet kryetari, "A mujte me kry ndonji landë?" Thashë, "Unë mbi 80 i kom kry". "Qysh more i ke kry?" "Mbi 80 i kom kry". Se pernime, landtë civile sa ma t'vjetra ma lehtë kryhen, sepse koha i ka zgjidhë ato probleme. Unë e dijsa kta, a po kupton a jo. Edhe i kom kry. Edhe mandej filloi tek kolegët me u ngritë autoriteti, normalisht a. Por, nëse din shumë n'mesin e atyne që kanë xhelozë është shumë problem. Edhe mandej ni kohë ka qenë ni gjyqtar hetues i cili nonstop ankohej se ka shumë punë edhe e ka punën e vështirë e kështu e ashtu edhe krejt.

Edhe në një prej kolegiumeve që i mbajshim, se për çdo javë mbajshim kolegiume, i thashë, "A din çka? Kryetar, gjysën e landëve merrja ktina birmi mu n'zyre. Edhe pse unë punoj në civile edhe kto hetimet i kryj hiç pa problem". Edhe i mora edhe landtë hetime. Punojsha njikohësisht edhe civile edhe hetime. Landtë ku kishte me kontabilitet punë, ku kishte krim financiar, a din, ata m'thirrshin edhe n'kolegj penal atje me marrë pjesë në ato. Kështu që, kom kry edhe ato landë, edhe kto, edhe ato, krejt. Veç gjykime penale nuk kom mbajtë. Kom qenë anëtar i trupit gjykues, po vet me gjyku nuk kom gjyku penale.

Anita Susuri: Po m'intereson çfarë raste ka pasë ma shumë n'qat' kohë? Thatë që jeni marrë ma shumë me këto rastet financiare, po a ka pasë, për shembull, po m'intereson, kto me gjakmarrje e ksi raste?

Adem Vokshi: Ka pasë raste, ka pasë raste gjakmarrje, ka pasë raste edhe raste penale janë ato. Ka pasë raste edhe krim ekonomik ka pasë. Por kryesisht u akuzojshin, për shembull, ata që mbajshin shitore. Ktyneherë kanë qenë shitoret e ndërmarrjeve tregtare edhe ata jepshin mall veresi e merrshin myshteritë me tefterin ose me libra, po. Edhe ata kur u bojke regjistrimi ua regjistrojshin si mungesë n'veprimtari edhe u akuzojshin për keqpërdorim të pasurisë shoqërore, për ksi... Mandej, ka pasë rast, m'kujtohet ni rast ma karakteristik ka qenë, ni depoist që ka qenë shef i depos, diku para se me mrrri unë në Mitrovicë në qershor kishte përjetu aksident komunikacioni edhe gati ka vdekë.

Ka vazhdu ndihmësi i tij me punu, me vazhdu punën edhe n'fund të vitit u konstatu ni mungesë bukur e madhe. Tash s'më kujtohet sa, veç shumë e madhe ka qenë. Edhe atë depoistin e rrasin n'burg. Edhe tash po mbahet gjykimi i tina edhe m'thirri ai kryetari i trupit, "A po vjen n'kolegj me gjyku këtë landë?" Thashë, "Po vi n'kolegj". Po gjykohej ajo landë edhe po e akuzojnë atë për qat' mungesë. Edhe u kry gjykimi, kur u kry gjykimi shkum me votu landën. Kur po shkoj unë n'zyre thashë, "Ku është gjykatësi?" Tha, "Ka shku te kryetari". "Po çka po don te kryetari?" Tha, "S'e di". Ai ka shku me landë te kryetari. Te kryetari shefi i kontabilitetit, ni përkthyes, vozitësi edhe ni shok i kryetarit po bisedojnë rreth landës sa me e dënu atë njeri.

Edhe unë kur hyna thashë, "A je normal bre? A kanë qenë kta n'gjykim? Ku e dijnë kta atje? Hajde kthehu n'zyre atje". Edhe u kthym n'zyre, "Çka po ta merr menja ty?" "Jo le t'votojnë porota niherë, mandej unë mandej ti. Se qashtu është procedura", "Jo, jo, ti çka po ta merr mendja?" Thashë, "Unë me liru". "Qysh more me liru", thotë, "duhet 15 vjet burg me ia dhanë". Thashë, "Veç tregom ni sen", thashë, "gjeje që ky i ka marrë qato pare". "Po", tha, "u dalë *manjak*-i".⁵ "A e ka vazhdu ndihmësi i tij punën? Pse s'u bo pranim dorëzimi i detyrës? Nëse s'u bo pranim dorëzimi i detyrës, ti veç ki supozim që ky ka mujtë me i marrë ato".

Fatkeqësia e tina ishte se i kishte dy çika t'mira edhe studiojshin në Angli, a po kupton a jo? Edhe për atë arsye, e dënnun, i mbledhën i zbritën krejt ia dhanë nëntë vjet. Edhe boni ankesën te Bajram Kelmendi, ni avokat i mrekullueshëm ka qenë, ai e mbronte. Edhe me ankesë Gjykata Supreme atëherë e prishi landën. E herën e dytë mandej prap kur u gjyku, prapë ia dhanë qaq, katër vjet po m'duket n'burg që kishte nejtë qato katër vjet ia dhanë. Mandej e kanë pritë me u parashkru ajo landë se s'kanë pasë mundësi, jo s'kanë pasë guxim s'kanë pasë me e lirue.

Njeri kur s'ka bo vepër pse e akuzon? Ose kur ki dyshime sepse është ai parimi *In dubio pro reo*, në rast të dyshimit atëherë ma e favorshme duhet me qenë vendimi i gjykatës ndaj të akuzuarit. Nuk ki prova.

⁵ Srb.: *manjak*, në minus.

Provat janë ato që e dënojnë dikë, ato që thashë pare, dy pa shpirt një pa kry. Nuk, nuk, kjo është ajo (qeshë).

Anita Susuri: Po m'intereson viti '81, demonstratat...

Adem Vokshi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë? Edhe prej këndvështrimit profesional po edhe kështu.

Adem Vokshi: '81-tën unë kom qenë gjykatës në Gjykatë të Qarkut edhe e mbaj n'mend demonstratat kur kanë ardhë minatorët... ndërtesa e gjyqit ka qenë n'pjesën veriore të Mitrovicës, atje ku o edhe tani ndërtesa... edhe kanë ardhë, krejt rrugët u shlirun, veç protestusit po vijnë. Edhe e di n'zyrën time, unë atëherë isha Sekretar i Organizatës të Partisë për Gjyq edhe Prokurori. Kur erdh edhe ni gjykatëse edhe ni prokurore erdhën, ishin tranu krejt... ata tash t'u brohoritë rrugës. "Kanë me na vra", kanë me bo kta, "Kqyrni revole me na pru", e qisi sende a din? "Mos boni hajgare, kush ka me ju vra juve? Po s'jeni ju ata që duhet me ju vra juve, mos boni hajgare. Hekmuni prej zyres ktu". Mu si sekretar, partia me intervenu në polici për me ju siguru atyre revole. Tash kur i shoh ata keshi edhe me njënin edhe me tjetrin çfarë magarie kanë bo.

Ata shkun për Zveçan, puntortë. Ishte e premtë unë shkojsha për Pejë po e kisha kerrin defekt edhe s'kisha me çka me shku. Në kamë jam nisë prej atyhit deri në stacion t'autobusave kam shku në kamë, kush s'më ka vet as qysh e kom emrin as, a po kupton a jo? Edhe kur kom mrri te stacioni e kom pa ni Islam Lushtakun, polic i komunikacionit. Edhe, "Ha gjykatës, çka ki dalë?" "Po du me shku në Pejë". "Nuk çarkullojnë autobusat". "Hajt ti je polic ndale ni kerr që shkon për Pejë edhe çom me to." edhe tha, "E ndali". Tamon njani po kalon regjistrimi i Kralevës. Ta ndali ai, "Ku po shkon?" Tha, "Për Pejë." tha, "Merre", tha, "kta me veti" (qeshë). Unë shkova në Pejë.

Qikjo ka qenë ajo. Njerëzit vetvetiu frikoheshin. Çka po lypin ata? Po lypin t'drejtat e tyre, po a është e lejshme? Po, pse mos me i kërku t'drejtat e tyre. Kjo ka qenë ajo. Edhe ni situatë shumë interesante, ka qenë në izolim Nexhat Daci edhe grupi tjetër prej intelektualëve atëherë që i patën marrë '81-tën. Kur n'zyrën time ishin veshë me farmerka si t'ndrrum, a din, vllau i Nexhat Dacit, profesori Hamdi Daci edhe profesori i ndjerë tani Shaqir Shaqiri, profesor i Fakultetit të Anglishtës.

Erdhën, "Po, hajde." "Jo, hajde dalim." "Çka u bo bre?" U frikoshin me ardhë n'zyre te une. "Po hyni mos boni hajgare". Edhe dola përjashtë. "Çka është n'pytje?" Tha, "E kanë marrë n'izolim, e kanë burgos Nexhat Dacin", tha, "edhe është n'burgun e Mitrovicës, a ka mundësi diçka me kqyrë asi?" Nejse, kqyrëm atje edhe e pamë që nuk... nuk kqyra unë po bisedova me drejtorin e burgut, kom pasë muhabet me to. "Çka është n'pytje?" "Hiç gajle mos ki, kërku nuk guxon me ta ngucë". Edhe qe, qishtu. Kjo ka qenë.

Anita Susuri: Më treguat që Mitrovica ka qenë qytet industrial ma shumë. A është vërejtë kjo? Qysh është vërejtë? Për shembull, ndikimi i Trepçës n'atë qytet a...?

Adem Vokshi: Trepça ka pasë n'krejt Jugosllavinë diku rreth 27 mijë punëtor. Ibushi ju tregon ma mirë, ai ma saktë i din se ai me numra përfekt osht' (qeshë). I dike krejt punëtorëve të Trepçës i dike ato numrat e krejt (qeshë). Kqyre, puntortë që kanë punu në Trepçë kanë qenë të orientum vetëm në Trepçë. Qat' rrogë e kanë marrë, kanë qenë me siguri rrogat e mira, unë nuk po di. Po kanë qenë edhe benefitet tjera. I kanë pasë ato bonat me t'cilat janë ushqy n'atë menzën e tyne, besa bonat që kanë marrë edhe ushqim me veti kanë çu te shpija e krejt. I kanë pasë pushimoret n'deti, i kanë pasë pushimoret në Veli Breg që kanë mujtë me i shfrytëzu puntortë, a din. Sa i kanë shfrytëzu nuk e di, po kam pasë ma pak kontakt me ta.

Por, Trepça si Trepçë e ka pasë... ndoshta politika ka qenë e tillë. Kanë maru banesa, kanë maru banesa, iu kanë dhanë kuadrave, por jo të Trepçës, i kanë dhanë ktij, atij, atij në Mitrovicë. Gjithkah, edhe policisë, edhe prokurorisë, edhe gjykatës. Atyne iu kanë dhanë banesa n'vend se me iu dhanë punëtorëve t'vet. Qikjo është ajo. Iu kanë dhanë edhe punëtorëve po punëtorë ka pasë edhe tjerë që kanë pasë nevojë për ato banesa e s'ju kanë dhanë atyne, po iu kanë dhanë tjerve iu kanë dhanë. Kjo ka qenë.

E mandej kur filloi me ra puna në Trepçë për shkak t'protestave, për shkak t'grevave, atëherë u vërejt shumë, sepse s'merrshin ma rroga edhe ekonomia filloi me ra totalisht. Edhe kur filloi ekonomia me ra mas '89-ës kur ndodhën ato protestat e minatorëve krejt Kosova, edhe jo vetëm Kosova, po kanë fillu me ndihmu. Niherë grumbullojshin mjete edhe materiale edhe ushqimore me iu pru e mandej u lidhën shumë bukur. Janë konë pasë lidhë, nuk e di tash a partia [në nivel republike] a partia ni tjetër pat' organizu me i taku familjet me familje. Demek ni familje n'atë anë me ndihmu ni familje n'këtë anë. E kështu kanë qenë shumë bukur.

Bile, bile m'kujtohet shumë mirë kur prej Sllovenisë kanë mbledhë edhe prej Sllovenisë mjete për me ua çu minatorëve mbas grevës, që ishte atëherë e minatorëve. Edhe ato pare, pushteti atëherë që ka qenë aktual i udhëhequr prej strukturave serbe nuk ka leju ato mjete me ardhë ktu. E qato mjete mandej janë përdorë për avokatët prej Sllovenisë kur kanë ardhë me i mbrojtë minatorët në gjykimin e [Azem Vllasit](#) e [Burhan Kavajës](#) e [Ibush Junuzit](#) e ktyne. Ata thojshin kanë ardhë pa pare me i mbrojtë, mandej e morëm vesh që ato mjete Lidhja Socialiste që i ka mbledhë atje, ju ka dhanë atyne me i kompenzu atë punën që e kanë bo ktu.

Anita Susuri: Kur ka ndodhë marshi, pas marshit kanë fillu me i marrë n'pytje shumicën e, edhe të udhëheqësve edhe të minatorëve...

Adem Vokshi: Po.

Anita Susuri: A keni qenë ju në dijeni të kësaj? Qysh ka qenë atëherë e organizume kjo? A është majtë dikush për me u... a u dënu? Po m' duket që janë dënu disa.

Adem Vokshi: Po, ka pasë, ka pasë të dënum për kundërvajtje, ka pasë të dënum. Përveç asaj meniherë mbasi i mashtrun minatorët se ka dhanë dorëheqje Husamedin Azemi, Ali Shukriu edhe ai...

Anita Susuri: Rrahmani.

Adem Vokshi: Rrahman Morina. Dulën minatortë atje edhe meniherë i burgosën Azem Vllasin, Burhan Kavajën, Aziz Abrashin, Ibush Jonuzin edhe 14 tjerë prej ktyne edhe ka qenë në atmosferë shumë e zyrtë, shumë e zyrtë. Ma e zyrtë se kur t'bjën shi e breshër e krejt ashtu u duke. Edhe pse koha ishte e mirë, po me t'vërtetë ka qenë frika deri n'palcë iu ka pa hi njerëzve. "Kqyre kur ni Azem Vllasin e burgosin, çka s'na bojnë neve". Qikjo ka qenë. Me t'vërtetë.

Ata prej fillimit është ditë se s'ka kurgjo prej asaj. Bile m'kujtohet n'gjykim kur i ndëgjojmë diskutimet e Azem Vllasit edhe në Trepçë që i kanë mbajtur edhe në sallën e sporteve ktu edhe n'ato t'rinisë; političar bre. Dy orë fol edhe s'munesh me ia ngjitetë kërkun çka gaboi sepse kurgjo, a po kupton? Qajo është ajo oratoria e političarit, fol dy orë edhe s'munesh me ditë kurgjo çka ka thanë. Edhe ata me vet çka ka thanë, nuk don...

E Azemi është një njeri i politikës i mrekullueshëm ë. E kena pasë Mahmut Bakallin političar edhe Azemi është i hatashëm.

Korab Krasniqi: Qysh ka qenë atmosfera? Po mendoj, shqiptartë pjesë e Jugosllavisë po ashtu, filloi situata politike me u përshkallëzu. Ju jeni me ni institucion t'naltë. Qysh...

Adem Vokshi: Ishin, ishin. Jo, une...

Korab Krasniqi: Situata ka qenë politike.

Adem Vokshi: Jo, unë '82-tën kom dalë avokat kom dalë.

Korab Krasniqi: Avokat.

Adem Vokshi: Po, prej '82-tës kom dalë. Kom dhanë dorëheqje atëherë prej pozitës t'gjykatësit sepse nuk kom mujtë me u pajtu me politikën që po zhvillohet. Edhe nuk jom pajtu me atë, po nuk kom mujtë as kurgjo me ndiku për me u përmirësu ajo gjendje. Edhe nëse gjindesh në një situatë edhe pajtohesh që le t'veprojnë ata po unë s'po veproj atëherë ti je bashkëfajtor. Edhe une kom dashtë me dalë. Kom kërku punë në Prishtinë në disa vende. Bile m'kujtohet n'ndërmarrjen tregtare ktu; kur kom pa konkuru m'ka pa prit ni burr i vjetër atëherë edhe, "Çka punon?" Thashë qishtu.

Edhe kisha dhanë dorëheqje po e pritsha tre mujshin me ma pranë dorëheqjen ose me u konsideru se m'ka pushu mandati. Ashtu ishte me ligj. Thashë, "Valla, kom qenë gjykatës edhe po du me dalë avokat me kqyrë ndonjë ndërmarrje diku me u strehu, po jo gjithçka me lypë". Tha, "Valla", tha, "Ky vend i punës që është shpallë, e kena njerin që kena me pranë. Ti si t'dush dorëzohet dokumentet". Edhe ajo mandej m'ka shty edhe kom dalë avokat. E kisha përkrahjen e Bajram Kelmendit atëherë, "Pse s'po del avokat? Çka po pret mo? S'ki kurgjo me pritë prej ktyne. Mos prit ndonjë vend t'punës t'mirë se s'ka vende t'punës t'mirë për intelektual sikur ti që je". Edhe unë atëherë vendosa edhe u regjistrova si avokat.

Korab Krasniqi: A ndikun protestat e '81-tës për me marrë në vendim me u largu prej punës që ki ushtru?

Adem Vokshi: Të drejtën me t'tregu ka qenë shumë interesant kjo pse e kom marrë në vendim t'tillë. E kom hala atë vërtetimin e kryetarit të gjyqit, se kur ma ka lshu se me çfarë date kom dhanë dorëheqje. Me 17 janar, '82-tës e vranë vllazërit Gërvalla edhe Kadri Zeka, unë t'nesërmen e kisha ditëlindjen. Edhe jom mat' me shku n'zyre edhe i kom thanë daktilografit, "Shtini tri kopje". Edhe ju kom drejtu Kuvendit të Kosovës, Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime me kërkesë për shkarkim.

Mundeni me marrë me mend, për ditëlindje. Ajo ishte kapaku i krejt asaj çka unë si Adem mujsha me bo, kurgjo ma shumë. Edhe po m'kqyre daktilografja tha, "A je tamon?" Thashë, "Po, shumë". Edhe e kom çu te sekretarja e gjyqit edhe i kom thanë, "Protokoloma këtë kërkesë". Sepse ajo shkojke përmes kryetarit të gjyqit. Edhe atë kërkesë e kanë mbajtur një muaj ditë n'fijokë kryetari.

Mbas një muaj dite m'ka thirrë, m'tha, "Ej hajde kha", tha, "kom bisedu me kryetarin e Gjyqit Suprem edhe me Ministrin e Juridikaturës", tha, "ti nuk guxon me shku prej ktuhit", "Pse s'guxoj?" "A po e sheh çfarë shtate osht'?" "Mos e kom kriju unë?" Tha, "Jo". "Mos muj unë me ndreqë?" Tha, "Jo". "Ditën e mirë!" Thashë, "Unë fmi nuk jom, sot po jep dorëheqje, nesër po e tërhjek dorëheqjen". Edhe kjo ka qenë arsyeja.

Edhe arsyeja e dytë ka qenë shumë e randësisë gati sa e para. Ka qenë, unë kom vendosë me qenë avokat në Mitrovicë jo me shku në Pejë që isha pejan; me ju tregu mitrovicalive se unë kom me pasë autoritet ma shumë si avokat se ata si gjykatës. Edhe qata e kom arritë (qeshë).

Korab Krasniqi: E arsyet që i keni shkru n'kërkesën e juj për dorëheqje, cilat janë kanë?

Adem Vokshi: Pa mundësia me ndiku n'përmirësimin e gjendjes me ju ndihmu njerëzve. Se unë e konsiderojsha... munesh me marrë me mend si avokat kur e kom mbrojtë në t'mitur, e kanë gjetë "KR" që shkruan, Kosova Republikë në Skenderaj edhe ia kanë dhanë 60 ditë burg. Edhe unë po boj ankesë,

“A jeni normal, ma s’pari ku e ditët që ky e shkrujtë ata? E mandej edhe nëse e ka shkru çka paska bo bre? Fmi o ky”. Qe qisi sende. Mos t’foli për gjana shumë, shumë t’mdhaja.

Korab Krasniqi: T’kthehemi edhe nihere te ‘88-ta edhe ‘89-ta, kur ju veç i keni hetu qito trazira, qito momentet kur keni vendosë me u largu prej punës, keni ushtru profesionin e avokatit e kështu me radhë. Po t’u afriu kah ‘90-tat situata shkon edhe përshkallëzohet...

Adem Vokshi: Për ditë e ma shumë.

Korab Krasniqi: Edhe me ardhjen e Millosheviqit në skenë, mandej qysh ka qenë atmosfera për juve sikur jurist, sikur avokat me funksionu edhe me jetu me nifare atmosfere të tillë politike? Qysh e keni përjetu qat’ kohë?

Anita Susuri: Domethonë, kur janë shkelë të drejtat n’përditshmëri.

Adem Vokshi: Në... ndëgjoni, ndoshta prej kësaj pozites osht’ ma lehtë me folë. Prej asaj pozitës, une kom mendu që gjithmonë do t’tejkalohej kjo situata sepse në kryesi të Jugosllavisë pat’ ardhë Janez Dërnoshevu, ni njeri i mrekullueshëm i Sllovenisë. N’kryesi të Jugosllavisë n’vitin ‘90-të kur ma kanë vra babën policia n’derë t’shpisë në Kapëshnicë. Atje ka qenë edhe Rizah Sapunxhiu, ish guvernatori i Bankës Botërore. Ai ka qenë i Pejës, Rizah Sapunxhiu edhe ni kohë kur baba im ka qenë drejtor në ni fabrikë atje, ai ka qenë punëtor i babës tim. Po ai ka arritë mandej ka qenë guvernator i Bankës Botërore edhe ka qenë anëtar i Kryesisë të Jugosllavisë, Rizah Sapunxhiu, tani i ndjerë, po atëherë...

Edhe mendojsha se me t’vërtetë ka me u, gjithmonë me shpresa, ka me u zgjidhë kjo situatë. Edhe m’kujtohet ‘89-ten une isha t’u ardhë prej Beogradit që e pata mbrojtë ni drejtor edhe ni zëvendës drejtor të Trepçës në Beograd atëherë kur ky Markoviqi erdh n’pushtet. Edhe ai n’qat’ kohë bash Komiteti i Jugosllavisë u prish, Lidhja Komuniste e Jugosllavisë u shkatërru edhe e pytën ata, “Çka po mendon që u shkatërru?” Tha, “Kurgjo Jeta do t’vazhdonte edhe pa Lidhjen Komuniste”. Edhe pernime ishin këta njerëz që i jepshin shpresë se mundet me u prit diçka pozitive prej krejt ktyne.

Përveç asaj, inflacioni ishte disa-shifrorë a. Edhe me ardhjen e Markoviqit u përmirësu gjendja sepse u stabilizoi dinari. Mandej n’janar t’vitit ‘90-të erdh ai Avramoviqi edhe ma shumë e stabilizoi dinarin edhe kjo m’jepte shpresë gjithmonë, sepse unë gjithmonë shiqoj gotën gjysmë t’plotë e jo gjysmë t’zbrazët edhe mendojsha se pernime ka me u zgjidhë kjo situatë. Jo pse unë muj me ndiku n’atë, po unë muj me atë mundin tim, a din, me ndiku që qajo t’përmirësohet. Qikjo ka qenë ajo.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Kur keni mbrojtë, domethonë ata t'akuzumit që kanë qenë të lidhun me rastin Trepça... Qysh, domethonë, une qysh e di ka qenë vullnetare kjo apo si ka qenë? Qysh keni marrë ju vendim me i mbrojtë ata?

Adem Vokshi: Nuk kom marrë une vendim me i mbrojtë ata, kanë ardhë familjartë edhe na kanë angazhu. Sepse është dashtë me u prezantu si mbrojtës edhe pse ka pasë mandej vullnetarë që e kanë mbrojtë Azem Vllasin, sepse ky iu ka vy për shkak t'emrit a din. Po une nuk hi n'atë. Ka ardhë vllau i Ibush Jonuzit, tash ia kom harru emrin si ka qenë ai, m'ka angazhu për Ibushin. M'ka ardhë bashkëshortja e Ramiz Kadriut, që ka qenë një prej atyne, jo minatorë, ka qenë referent atje çka ka qenë, ajo m'ka angazhu. Ka ardhë vllau i Veli Osmanit edhe ai m'ka angazhu. Se di edhe dikond tjetër, tash kom harru, a din veç e di i kom pasë tre ose katër t'akuzum të cilët i kom mbrojtë atëhere. Edhe e kena prezentu autorizimin n'gjykatë edhe kena tentu me argumentu se ata njerëz nuk kanë faj. Sistemi i tillë ka qenë atëhere, sistemi akuzativ. Por jo obligimi i akuzës me vërtetu se ti ki faj, po obligimi i t'akuzumit me vërtetu pafajësinë.

Bile, m'kujtohet Ibush Jonuzin disa here e kom vizitu në burg edhe ai qante, qante. "Kurgjo s'kom bo", thojke, "Qysh?" I kishte nantë fmi, sa i kishte? Nihere, nihere, nihere. Dikur i thashë, "Ibush bre", thashë, "me bo nesër me dalë prej burgut ti edhe me shkatërru vetën, çka i vyn asaj familje? A s'ke bo kurgjo?" "Jo", tha, "kurgjo s'kom bo". "Po cili ka bo diçka? Përveç teje osht' Burhan Kavaja n'burg, osht' edhe Aziz Abrashi, osht' edhe Azem Vllasi qi ka vro e ka kfillë, edhe ai osht' n'burg. Nesër do t'vërtetohet që s'keni bo kurgjo edhe ti i vyn qasaj familje. Kta qëllimin e kanë", mendojsha për pushtetin, "me ju shkatërru juve sepse jeni njerëz intelektualë edhe qata".

Krejt katër-pesë minatorë i kanë marrë, demek po gjykohen minatorët e në të vërtetë ishin kta. Çka kishte vllazërit Krasniqi me u akuzu me grupin e Azem Vllasit? Ai ishte drejtor i KEK-ut ktu në Prishtinë, e tjerë, e tjerë. Qikjo ishte ajo. Ka folë me minatorët, çka ka bo tjetër? Ka folë edhe Stipe Šuvari prej Kryesisë të Jugosllavisë ka folë me minator edhe ato s'e shtijnë n'burg e tjerë, e tjerë. Kurgjo s'kishte n'atë landë. Mirëpo, atëherë gjyqtarë hetues ishte Avdi Dinaj, tash është avokat në Mitrovicë; me to në gjeneratë kena qenë edhe n'studime, e ai ia besoi zhvillimin e hetimeve Rexhep Kaçanikut.

Rexhep Kaçaniku ka qenë gjykatës hetues në Mitrovicë, atë që e përmenda pare. Po, ndërkohë e lëshoi gjyqin edhe shkoi me punu në Sigurimin Shtetnor. Edhe atij ia besun tash hetimet edhe ai na thirrke, edhe të akuzumit edhe neve avokatëve kur i merrke n'pyetje të akuzumit, kur i merrke n'pyetje... po as dëshmitar s'kishte a. S'kishte kurgjo se s'kishte ku me ia ngjitë. Ata ishin organizu në mënyrë spontane. Nuk kishte ndonjë udhëheqës i cili, barëm barëm në gjykim nuk është vërtetu, ndonji udhëheqës që i ka organizu ato.

Sepse gjithmonë pretendohej se Burhan Kavaja, Aziz Abrashi, Azem Vllasi kur kanë qenë n'vizitë i kanë organizu për me i bo qato. Po ishte veç ni shprehje spontane e paknaqësisë a. Edhe, a din si osht', ai tetë orë po rrin n'zgafellë atje, s'po e sheh dillin, tetë orë flen edhe veç tetë orë n'dite munën me pa

dillin edhe i vjen deri ktu {shpjegon me duar} edhe ma n'moment nuk pajtohet me krejt ato. Si thashë, paret që po fitohen aty ku po shkojnë ato?

Atëherë thojshin po mbarohet Beogradi, po mbarohet edhe ktu, si thashë banesa e krejt privilegjet po i shfrytëzojnë dikush tjetër. E kanë pasë ni restorant atje "Trepça Komerci", te stadioni në Mitrovicë. Atje shkojshin krejt kta udhëheqësit me hanger atje se "Trepça Komerci" i pagun ato. Krejt n'shpinë të minatorëve shkojshin ato. Sa janë ato t'mdhaja sa janë t'vogla po edhe ni dinarë nëse e run është për krejt ata njerëz, a din, që e meritojnë sepse prej djersës t'tyne po fitohet krejt ajo.

Anita Susuri: Pse ka qenë aktakuza edhe në bazë të aktakuzës cili ka qenë mendimi ju? Çka kanë mendu?

Adem Vokshi: Kontrarevolucion ka qenë aktakuza, neni 114 nëse e mbaj n'mend kështu. A din, po kanë organizu rrxumjen e pushtetit. Se kërkesat e minatorëve ishin dorëheqja e ish udhëheqësve me të cilët nuk pajtoheshin asnjëni. As qytetartë e tjerë, edhe ata me pat' pasë mundësi ishin dalë, a din, me protestu e le mo minatortë. Kjo ishte ajo. Këta janë organizatortë të rrënimit të pushtetit, sepse pushtet u qujke atëherë, Ali Shukrija, i cili ishte në Kryesi të Jugosllavisë. S'ishte në Kryesi të Jugosllavisë po ishte, atje, në nifarë udhëheqësie. Azem, ky, Hysamedin Azemi, ai ishte ni qasi udhëheqësi. Rrahmon Morina erdh në vend të Azem Vllasit, normalisht kta nuk u pajtojshin me atë e tjera. Erdh gati si me zor erdh. Gati si me zor jo, po me zor. (Qeshë)

Anita Susuri: Ju përmendëm edhe ma herët për atë thanjen e ju na ka tregu Ibush Jonuzi kur keni thanë që dy pa shpirt e një pa kokë. Po nëse mundeni me na tregu për, nëse ju kujtohet qai takim edhe pse keni thanë ashtu?

Adem Vokshi: Gjithmonë klienti pyetë qysh ka me kalu edhe një prej thanjeve t'mija kur bisedon me klientin, nuk i garantoj kurgjo hiç. Edhe aty ku mundesh me qenë i sigurtë njëmijë përqind nuk guxon me i garantu, sepse gjykata është ajo që vendosë. Edhe jo gjykata, po sot ishte ni klient i cili e kishte fitu kontestin në Gjykatë Themelore, t'cilit iu kishte vërtetu vendimi në gjykatën e shkallës t'dytë; Gjykata Supreme i ka ndryshu dy kto vendime edhe ia ka refuzu kërkesën. Edhe tash n'çfarë pozite unë si avokat gjindna nëse klientit i garantoj për diçka që unë e konsideroj se ai ka t'drejtë. Kjo është ajo.

E Ibush Jonuzin i kom thanë, "O Ibush, mos harro se këtë thanjen popullore, dy pa shpirt një pa kokë". Vijnë dy dëshmitarë edhe thojnë se Adem Vokshi e ka vra njënin, gjindet kufoma. E ka vra krejt dikush tjetër atje. Po s'ka prova tjera edhe Adem Vokshi nuk mundet me argumentu pafajësinë edhe dënohet me vdekje. Për qata dy pa shpirt janë ata dëshmitartë që dëshmojnë kundër teje rrejshëm edhe ti shkon e ngel pa kokë. Kjo është ajo thanja (Qeshë).

Korab Krasniqi: A mundesh me tregu që kontekstin e diskutimit që e keni pasë me Jonuzin, pse pikërisht i keni zgjedhë qito fjalë? A keni dashtë me i thanë që ai...

Adem Vokshi: Mos, jo, dëgjo. Kjo është arsyeja që une nuk i jep shpresa të rrejtshme njeriut. Sepse gabimi më i madh është nëse e mban dikond në shpresa të rrejtshme edhe në fund zhgënjehet, që qikjo është qajo. M'kujtohet në klient kur erdh te une ishte në seancë ose dy seanca penale edhe m'tha, "Më kanë thanë", tha, "që s'ka nevojë", tha, "me ardhë ti hiç. E kom rregullu me pare. U kry". Thashë, "N'rregull". Edhe ishte vepra penale që ishte atëherë për plaçkitje minimumi në vjet, s'kishte mundësi nën në vjet me shku.

Kur ka ardhë masdite edhe po m'tregon tha, "E mora në vjet burg", "Pernime?" "Po", tha, "veç qysh pat' ftyrë bre ai me ma dhanë në vjet?" tha, edhe kta e kom bo për ta edhe kta, "Me gjykatësin që kemi bisedue". Qikjo është ajo s'ka (qeshë). Për qita nuk guxon asniherë me i premtu. Une kryesisht merrna me civile, merrem edhe me penale, po qysh me i premtu njeriut për diçka t'tillë.

Anita Susuri: Ata janë akuzu në baza të rrejtshme, për shembull, për Ibush Jonuzin kanë thanë që ky ka ditë çdo detaj për secilin punëtorë. Si është e mundshme që s'ka ditë se po organizojnë grevë? Kjo domethonë ka pasë disa që kanë folë kështu për to. Sa ka qenë kjo e vështirë për juve? Për me gjetë fakt ose qysh janë ditë faktet?

Adem Vokshi: Tash, tash tregoj në situatë, jo me Ibush Jonuzin po me Ramiz Kadriun, njërin prej atyre t'akuzuarve. Isha në vizitë te ai edhe vizita në zyrë të drejtorit. E kishin përgatitë ata vizita në zyrë t'tyne, okej. Une me drejtorin kisha muhabet sepse njiheshim profesionalisht edhe kur kam qenë gjykatës edhe krejt. Edhe në mes tjerash, kështu drejtori po i thotë, "E Ramiz tregona se kta kanë organizu kta", "Kush janë kta?" Une, po tha, "Qe Azemi e Azizi e Burhani e Ibushi". "Çka kanë organizu?" "Qito". Po ia bon ai tha, "Unë nuk di që kanë organizu diçka, une s'kam qenë organizator, as nuk e di që ka pasë organizatorë aty". Se në të vërtetë nuk kishte organizatorë aty.

"Kqyre", tha, "ku i kena fotografijat". [Fotografijat] e atij me në femën tjetër, çka po di une. "Kena me ia tregu grusë tande", tha, "edhe kena me ta prish martesën". Tha, "A po na tregon a jo?" Edhe une po ia boj me sy që mos u dorëzo a. Po ia bon, "Nuk di", tha, "se me ditë ju tregoj, po s'ka kurgjo prej kësaj". Qe qishtë është ajo. Domethonë, me qisi intriga janë mundu me gjetë njerëz për me argumentu kto. Une, m'kujtohet edhe një prej drejtorave të OUR⁶-it çka po di unë atje, e kishin prurë si dëshmitar ato. Edhe kishin bisedu kta të Punëve të Brendshme me to edhe kur erdh edhe po tregon sinqerisht po tregon çka ka ndodhë çka s'ka ndodhë.

Edhe, "Kush ka qenë organizator?" Tha, "Po, nuk e di", tha. "Jo", tha, "po ti na ki thanë neve qishtë qishtë", "Oh", tha, "nuk e kom thanë une", tha, "Ju keni thanë", tha, "Edhe m'keni thanë mu që unë me pranë që qashtë osht', po unë nuk e di që osht' qashtë". Kom harru tash cili prej dëshmitarëve ka qenë, Maliqi nëse e mbaj në mend mbiemrin. Po nejtse p'e di që ai qishtë ka thanë. Domethonë, prej Sigurimit

⁶ Organizacija udruženog rada (OUR) - Organizata e punës shoqërore.

Shtetnor i thirrshin njerëzit që kanë punu në Trepçe me argumentu se ato kanë qenë të organizume edhe qëllimi ka qenë me rrxu pushtetin e Jugosllavisë. Trepça po e rrxon pushtetin e Jugosllavisë.

Anita Susuri: Unë e di edhe që edhe mbrojtjen kur e kanë pasë kta që gjithmonë e kanë mbrojtë njani tjetrin, por kurrë vetën. Qishtë kom dëgju. A ka qenë kështu?

Adem Vokshi: Po, kqyre, s'ka pasë qysh me mbrojtë as tjetrin as vetën, me vetë deklarin e tij ai i ka mbrojtë t'gjithë. A je organizu? Jo. A t'ka organizu dikush? Jo. Me pa organizu dikush edhe kta me pa thanë jo, atëherë po e mbron dikon tjetër po në të vërtetë s'kishte organizim. Ndoshta dikush tjetër, po a po hyjmë n'grevë? Po hyjmë n'grevë. U ka folë dikush, po jo ku me ditë dishka e organizume.

Anita Susuri: Edhe ky drejtori i burgut të Mitrovicës ka qenë me nam shumë t'keq, ka qenë i ashpër po m'duket. A po ju kujtohet ndonjë rast që e keni vërejtë që ka qenë?

Adem Vokshi: Une personalisht jo, sepse tretmani ndaj meje, ndaj klientave t'mi ka qenë shumë i mirë, shumë kolegjial ka qenë. M'kujtohet nihere kur pata shku me vizitu ni kliente femër që e mbrojsa, se aty ka qenë edhe burgu për femra. Edhe ni polic roje i burgut, ai ishte ni i zi, mos me i thanë ndryshe, i zi edhe ai mu m'kishte inat shumë. Edhe une tashti t'u bisedu me të, ai e ka hapë derën krejt edhe po shiqon. E kishte atë dritaren ku mujke me shiqu, a din, po jo edhe me dëgju se ishte biseda të ndalume [konfidenciale]. Edhe une ia mbylla derën, veç kur e ka çelë derën, tha, "U ndërpre biseda". Ajo femra qe qikaa ftyrën {shpjegon me duar}. E mbrojsa për vrasje atë femrën.

Edhe nejse une dola prej atyhit edhe po kërkoj pranim te drejtori i burgut edhe ai m'pranoi. "Çka është n'pyetje?" Thashë, "Ai majmuni atje s'po m'len me zhvillu bisedë qysh duhet me femrën". "Ai ka t'drejta me t'shiqu". Thashë, "E ka dritaren aty, le t'shiqu. Por, jo me çelë derën me m'dëgju mu". "Ki të drejtë", tha. Edhe e thirri atë femnën n'zyre t'drejtorit, ia dha kafën me pi. A din, ka pasë qëndrim. Une nuk kom vrejtë që ka pasë ndonjë qëndrim. Thojnë që ju ka bo malltetime ndoshta t'burgosurve. Une e kom lexu ata që Vllasi ka thanë, ja u ka shti zhiletin aty e çka po di une, po për ato kur t'bisedoni me Vllasin ua tregon, po une qato nuk i kom vërejtë. Ndoshta të burgosurit dijnë ma shumë për mentalitetin e tij edhe veprimin e tij. Qikjo osht'.

Anita Susuri: Dashta me ju pyetë masi keni qenë aty avokat i Ibush Jonuzit, ai ka qenë i vetmi që është dërgu në Beograd pse ka ndodhë kjo? A ju kujtohet?

Adem Vokshi: Unë nuk pasna informatë ose nuk po m'kujtohet. Nuk e di.

Anita Susuri: N'rregull. Na ka tregu ai po...

Adem Vokshi: Okej, okej. Po une nuk e kom këtë informatë (qeshë). Une nuk e kom këtë informatë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë pastaj? Qysh ka vazhdu krejt kjo, ky gjykim? Qysh ka qenë atmosfera? Pastaj familjartë qysh janë ndje? Çfarë pritshmëri kanë pasë? Po mendoj, ju çfarë pritshmërie keni pasë?

Adem Vokshi: Atmosfera ka qenë shumë e zymtë. M’kujtohet niherë Avni Gjakova kur pat’ ardhë edhe para se me fillu gjykimi kërkon prej kryetarit t’trupit tretman ma ndryshe ndaj avokatëve. “Nëse nuk do t’kemi tretman”, se na kontrollojshin shumë kijamet, kijamet, a din, “Nëse nuk do t’kemi tretman, atëherë kur do t’vijmë herën tjetër do t’vijmë lakuriq. S’ka nevojë me na kontrollu qashtu”, a din. Qisi kontrolla kanë qenë shumë t’ashpra. Por, gardianët kur kanë qenë shqiptarë ka pasë ma t’butë, a din. Por, ka pasë gardianë serbë aty që janë sillë bajagi ashpër me t’akuzumit, me neve avokatë nuk kanë pasë konflikte t’tilla.

Po atmosfera ka qenë që kur shkojshe me i vizitu t’malltretojshin ty, prit gjysë ore, ni orë, ni orë e gjysë, dy. Me ta hupë kohën, a din, për sa ma rrallë na me lakmu me shku me i vizitu klientat me bisedu me ta. Kjo ka qenë. Edhe ka qenë situata bile për mu shumë e randë sepse me 16 shkurt ‘90-ës, hala vazhdonte gjykimi i Azem Vllasit, mu ma ka vra policia babën në Pejë, në derë t’shpisë atje. Edhe u ka pasë ndërpre gjykimi për dy-tri ditë. Mandej ka vazhdu gjykimi, po unë nuk kom ardhë, tek mas nja dhetë dite kom ardhë në gjykim. Ka qenë, nuk e di as sot qysh e kom përballu krejt, krejt atë gjendje, me të vërtetë shumë të randë.

Anita Susuri: Për qita po du me ju pytë tash, për qysh ka ndodhë kjo? Pas saj është, me ni gjykim që s’më kujtohet a Burhan Kavaja apo Ibush Jonuzi kanë dalë zyrtarisht ngushëllime iu kanë shprehë në seancë gjyqësore...

Adem Vokshi: Azemi.

Anita Susuri: Azemi.

Adem Vokshi: Po, po, në rregull. Okej.

Anita Susuri: Edhe e di që ata kanë thanë me veti që qitash edhe ma keq na ke bo. Domethonë, i ke akuzu vrasësit e...

Adem Vokshi: Aha, aha, po, ata kanë konsideru...

Anita Susuri: Fillimisht si ka ndodhë ai rast?

Adem Vokshi: Ka qenë e premtë edhe ka qenë, po m’duket Veli Osmani ka dhanë deklaratën atë ditë nëse s’gabo. Ka qenë deklaratë shumë prekëse. Ka qenë saqë u ndërpre gjykimi edhe prej trupit gjykues u pa që nuk ka ma efekt me mbajtë gjykimin, sepse filloi, filloi nifare vullneti, nifare lëvizje te

njerëzit edhe lëvizje pozitive n'atë kuptimin edhe u ndërpre gjykimi. S'ka ma gjykim, e vazhdojmë t'hanën. Edhe une erdha te shpija. Kur po bon telefoni po lajmërona une, nana po m'lajmëron, tha, "Adem", tha, "abejen", babën, tha, "E kanë plagosë në qafë", tha, "e kena çu n'spital. A priton me ardhë?" "Jo".

Kerrin e kisha defekt edhe s'kisha kerr. Shkova ni shoqës ia lypa kerrin edhe erdh dhandrri saj me kerr m'ka çu për Pejë, por kah Mitrovica në dalje të Pejës ka qenë e bllokume rruga sepse kanë qenë protestat e qytetarëve, gjujtja me gaz lotësjiellës e krejt qysh edhe veprojshin ato. Edhe m'ka pru kah Prishtina, ktu e kemi marrë vllaun e vogël në Prishtinë se ai ka qenë t'u studiu ende. Edhe kena shku në Pejë. Kur kom shku në Pejë e kom çu nusen me bineq atje n'shpi te nana e baba vet atje.

Edhe i kom thanë, "Rri ti ktu me fmi". "Jo", tha, "une me ty. Ku je ti edhe une". Kena shku n'spital edhe atje m'kanë lajmëru që baba ka vdekë. Mandej kom shku n'shpi. Nejse, normalisht ngushëllime nanës edhe atë natë me kerr të policisë e kena çu babën në spital në Prishtinë me bo obduksionin. Kom tentu me mjekë, meqenëse njifësja me ta me kry menjëherë obduksionin, nuk e kanë kry edhe të nesërmen kom ardhë në Prishtinë. U kry obduksioni edhe jena kthy për Pejë.

Ka qenë e bllokume krejt Peja ka qenë atë ditë t'vorrimit. Ka qenë shumë interesant se qysh kanë mrrri njerëzit me ardhë n'vorrim; unë edhe sot nuk e kom t'kjtartë. Ka qenë kolona e njerëzve prej vorrezave në Pejë, tash vorrezat ku janë në Pejë e deri te Hotel Korza në Pejë, tash Hotel Dukagjini. Atje ka qenë kolona qe qishtu e madhe. Edhe une frikë kom pasë mos po bohet masakër me atë popullatë.

Ka qenë pushka e mitrolezi mbi Hotel Dukagjinin atje i drejtum, nga popullata i drejtum edhe dy orë para se me u përcjellë, para se me ardhë kufoma me u përcjellë, kanë dalë n'protesta kta, a din, edhe policia i ka shpërnda policia. I kom pasë edhe ato fotografia, ka qenë Hazir Reka që i ka bo krejt ato fotografia, m'i ka pa dhanë po ndodhi lufta edhe hupën krejt ato.

Baba im ka qenë, siç thashë, a din, ni esnaf dugojxhi edhe te Ura e Kapeshtnicës, Ura e Zallit që quhet atje, fmitë kanë dalë n'atë anë edhe kanë gjujtë me gurë policinë n'këtë anë urës. Përditë ashtu ka ndodhë. Edhe ky normalisht, "Fmi bre, largohuni, largohuni! Po ju mbytë ndonjëni, po gjun me pushkë e ato. Largohuni, largohuni". Po edhe normalisht policia i ka evidentu ato, se policisë nuk i ka konvenu qetësia, i ka konvenu trazinat edhe për me bo zullum n'popullatën. Krejt me qëllim që Millosheviqi ma n'fund e tregoi me na përzanë krejt prej ktyre trevave.

Edhe n'atë, ni natë përpara, ni natë përpara, flitet po nuk e kom t'konfirmume edhe pse njëri m'ka premtu me ma konfirmu po iki përjashta edhe nuk e konfirmoi. Policia është shëtitë nëpër Kapeshtnicë, që në Kapeshtnicë kurrë policia nuk është shëtitë, kurrë nuk është dalë. Ka qenë tabu për policinë Kapeshtnica, përveç për ndonji polic që ka punu, se shumë pak serbë ka pasë, mos me thanë krejt pesë-gjashtë familje a kanë qenë serbë a jo. Edhe t'nesërmen kah 14:30, 15 në 15 ka dalë policia.

Në fund të rrugës atje ka qenë ni shtëpi, tash është rrxu ajo shtëpia është rrënu. E ni dentistit serb ka qenë ajo. Aty u mbledhshin ushtarakët, aty e patën bo si shtëpi publike të ushtarakëve ato edhe prej qasaj shpisë u pa shtëpia ime. U pa dera e xhamit edhe mrapa o xhom atje edhe drita kur bjen atje shihet figura kush o mrenda. Edhe tash fmija kur kanë hi, gjithmonë kanë hi kah shpija jonë edhe kanë dalë n'atë anë edhe kah shpija e fqinjëve janë ikë. Por fqinjin e parë e kena pasë ni sërbe shumë të poshtër, nifarë Zarka ka qenë. Edhe normalisht ajo ka tregu kah po ikin edhe kta policë të kanë punu. Edhe kur kanë dalë atje policia nja 200 vet kanë qenë n'aksion. M'ka tregu prokurori Bujar Juniku që ka qenë i ndjeri prokuror i qarkut edhe njëri me pushkë, me siguri me snajper, e ka gjujtë babën edhe e ka mbytë. Kjo është ajo.

Mbas ni kohe unë kom pa shku te prokurori i kom marrë krejt dokumentat që i ka prokurori atje t'pregatitne atje, m'i ka dhanë fatbardhësisht se jom njoftë me to, kom pasë muhabet. Edhe m'ka lutë, "Jo, sot", se ishte e premte, "eja nesër n'ora 10:00 t'i jap krejt dokumentet". Edhe unë kom menu që po më mashtron veç me m'hekë qafe, a din. Po n'ora 10:00 unë aty u vizatova edhe ai erdh aty i fotokopjoj. "Kqyre", tha, "kanë qenë 200 policë n'aksion", tha, "une kom kërkua me u bo ekspertiza e atyne pushkëve me t'cilën pushkë u qit. M'i kanë pru", tha, "Vetëm 20 pushkë, vetëm 20 pushkë i kanë bo ekspertizën edhe u vërtetu që asnjëna nuk u qit' prej tyne".

Tha, "Une prapë kom kërkua", i kishte ato kërkesat, "por," tha, "nuk po dojnë me vërtetu". Thashë, "Bujar edhe me vërtetu e gjojnë ndonjë polic atje ndonjë qisi pijanec edhe ta qesin pangël t'zezë edhe ta dënojnë katër-pesë vjet. E çojnë në Serbi me vujtë dënimin edhe kurrë ai nuk rrin as n'burg as hiç", a din, po s'ki çka i bon. Qikjo ka qenë, a din. Ka qenë shumë randë. Për mu shumë randë, çka me bo, qishtu jeta.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Po kthehem te gjykimi...

Adem Vokshi: Te gjykimi, po. Ishte interesant, m'u dukë mirë, unë e ndjeva vetën mirë kur, sa e mbaj n'mend une, i akuzumi Azem Vllasi atëherë u çu edhe n'emër të gjithë atyne t'akuzumve m'shprihi ngushëllime për vrasjen e babës tim. Ndoshta dikush edhe e ka kuptu atë, se pozita e t'akuzumve është vështirësu po nuk besoj që ka qenë e vështirësu për arsye se ne e njifshim mentalitetin e atyne gjykatësave. Bile une e kom njoftë shumë mirë mentalitetin edhe ata gjykatësat e kanë ndi vetën keq për atë që m'ka ndodhë mu, sepse ata nuk e kanë marrë atë si vrasje t'qëllimshme, po si vrasje e rastësishme. Edhe pse ajo ishte vrasje e qëllimshme. Me qëllim që neve, avokatëve, me na frikësu edhe me eliminu ni njeri i cili po i peshat ato protesta e fëmive t'cilat po mbahen çdo ditë në Pejë.

E pastaj, në trupin gjykues ka qenë Ismet Emra, kryetar i trupit gjykues. Ka qenë anëtar i trupit Jusuf Mejzini, si gjyqtar profesional. Ka qenë Shaban Binaku, ish minator i mrekullueshëm edhe ka qenë

shumë smutë, edhe ne nonstop u takojshim me axhën Shaban edhe e lutshim, tani është i ndjerë, edhe e lutshim, “Amani t’koftë mos u smuj deri t’përfundon gjykimi”, se ishte ni gjyqtar i cili e zëvendësonte atë. Ai ishte musliman, por ne u frikësojshim prej tij shumë se ka qenë nëpër Komitete, n’punë e krejt e u frikësojshim prej tij shumë. Po ishte edhe ni gjyqtar tjetër malazez, Milutin Zubov, po edhe ai ishte shumë pozitiv.

Kështu që, për vendimin përfundimtar kena shpresu edhe kena besu që me t’vërtetë do t’ndodhë vendimi pozitiv edhe kta do t’lirohen. Posaqërisht kur t’njejtën kohë prej kryesisë së Sllovenisë është kërku me u bo abolimi i Azem Vllasit edhe grupit t’tyne. Prej, në Kroaci ka pasë protesta t’mdhaja në përkrahje të minatorëve. Ka pasë protesta, ka pasë protesta... m’kujtohet ni doktor ka qenë që ka bo protestë me grevë në Kroaci, bash për lirim e minatorëve. Tash ia pasna harru emrin, nuk po m’kujtohet, por po e di shumë mirë. Edhe plus opiniononi botëror i kishe sytë e kthym nga ky gjykimi.

Ishin avokatë prej Sllovenisë, prej Kroacisë, prej Maqedonisë që merrshin pjesë në atë gjykim. Ishin avokatët që mbrojshin minatorët s’bashku me neve, ishte Doktor Miha, jo, Doktor Peter Ceferin ishte, ishte Miha Koziq që janë taku me ta në Vienë. Mandej ishte kryetari i Odës... atëherë nuk ishte, po ishte kur u takova me të ishte Kryetar i Odës të Sllovenisë. Ka qenë ni Danilo Canoviq, ka qenë i Beogradit. Ka qenë, ka qenë Zhelko Ollujiq avokat i Zagrebit. Ai ma vonë ka qenë kryeprokuror i shtetit të Zagrebit kur u pavarësua Kroacia, e tjerë, e tjerë. Domethonë, krejt opiniononi botnor ishte i kyçun atje.

Me siguri kjo ka kontribu në ftohjen e atmosferës edhe kur s’kishte prova, qysh me i dënu njerztë pa prova? Sepse krejt u merrke vesh se çka po ndodhë n’gjykim. Domethonë, s’ka prova qysh po i dënon kta njerëzit? Edhe, nuk besoj që ka pasë ndonji sugjerim prej pushtetit m’u liru këta njerëz, po me siguri nuk ka pasë sugjerim që me u dënu këta njerëz. Edhe fati i krejt asaj ka qenë që ma n’fund edhe u lirin, mbas 14 muj paraburgimit.

Anita Susuri: A ju kujtohet qajo ditë?

Adem Vokshi: Po, sigurisht.

Anita Susuri: Si ishte?

Adem Vokshi: Shumë, shumë, shumë (buzëqeshë) krejt Mitrovica. Nuk e di, tash po m’duket e vogël Mitrovica sa kanë dalë me prit edhe me duartrokitë atina. Edhe me u mshef mandej serbët nëpër dritare veç me kqyrë, t’u u friku çka po ndodhë krejt, a din. Qikjo ka qenë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë gjatë qasaj seancës kur osht’ lexu... sepse e di që shumica nuk e kanë pritë që kanë me shpëtu?

Adem Vokshi: Nuk e kanë pritë, nuk e kanë pritë. Po, ka qenë, me t'vërtetë shumë entuziaste. Bile t'u dalë me, kom qenë me kolegun Xhyran Demën, kur po dalim edhe ata të Sigurimit Shtetnor po na kërkojnë ato kartvizitat {shpjegon me duar} që hyshim n'gjykim me ato. Edhe po, ia murrën Xhyranit edhe une po ia marrë. Thashë, "Ama, kha more", thashë, "e kom bajtë gjashtë muj ditë", thashë, "Suvenir kom me ruajtë ktu". Thashë, "Shtine n'xhep Xhyran. Mos ua jep hiç" (qeshë). Edhe u shukatën edhe ata se edhe ata u zbehën se u lirun kta edhe qëndrimi i tyne veç shumë shumë u zbut.

Anita Susuri: E po m'intereson nëse ishin dënu sa edhe qysh ishin dënu?

Adem Vokshi: Ndigjo, unë kam qenë n'gjykim në vitin 1982 kur dola avokat mbas nja dy muj dite, e kom mbrojtë Halil Alidemën, ju kini ndëgju për Halil Alidemën? [i drejtohet intervistuesës] Ai, faji i tij ka qenë se ka qenë hale n'sy të pushtetit. Ia kanë qit ni trakt po ia kanë gjujt prej jashtit, Sigurimi Shtetnor, kërkush tjetër hiç. Edhe ai e ka marrë, e ka lexu qata edhe e ka çu n'podrum e ka shti n'furrë atje poshtë, me mshefë. N'vend se me djeg, me mshefë. Këta e kanë ditë që e ka atë [dokument] edhe kanë ardhë e kanë marrë edhe e kanë dënu njëmbëdhjetë vjet burg. Ukshin Hotin n'qat gjykim e kanë dënu nëntë vjet burg a, e tjerë, e tjerë a. Qe, qikjo është ajo.

Edhe ktyne, nëse kishin me u shpallë fajtor, atëherë i pritke dënimi prej disa vitesh. Mos t'supozoj, po prej disa vitesh. Por, fatbardhësisht se u ndrru krejt atmosfera [politike]. Atëherë kur u dënu Halil Alidema, atëherë ka qenë ni terr total ka qenë. Total ka qenë '82-tën që s'ka pasë as s'i ka interesu as mjetete të informimit, as ktyne, as atyne. Fundi fundit edhe mjetet e informimit kanë qenë t'gjitha destruktive n'atë kohë.

Anita Susuri: Po m'intereson vetëm edhe, domethonë pas gjykimit po m'duket që ka qenë rreziku prapë për ta që me u burgos prapë ose me dalë diçka me nxjerrë diçka prej kësaj. A ju kujtohet kjo? Ka qenë ni frikë edhe kjo, po m'doket i ka detyru edhe Avdi Ukën e disa tjerë me u largu prej vendit. Po m'duket që ka qenë kjo.

Adem Vokshi: Ndigjo, gjykata kur bjen vendimin çfarëdo vendimi t'bjen palët kanë të drejtë ankese. Nëse o vendimi lirues, prokurori atëherë, i ndjeri Spaso Zanfiroviqi, ai ka pasë t'drejtë me bo ankesë edhe me kërk për me u ndryshu ajo gjykim edhe me u shpallë fajtor kta. Qajo ka qenë frika a. Por nuk ka qenë frikë ku me ditë sa e bazume, sepse gjykata prej pesë gjykatësave po t'liron aty, nuk t'liron bash kot e kot a. Edhe ai ka mujtë me bo ku me ditë çfarë ankese, por jo me ndryshu diçka. Ka mujtë vetëm me e kthy landën n'rigjykim me u gjyku për s'dyti. Eh, atëherë ka pasë rrezik që ata me u dënu. Po, jo vetvetiu kështu, a din. Pa qat ankesë nuk ka pasë ndonji rrezik. Bile, unë nuk kom prit ndonjë rrezik çak edhe nëse bon ndonjë ankesë prokurori.

Anita Susuri: Si kanë vazhdu këto vitet e '90-a për juve? Kanë qenë vite t'vështira muj me thonë kur janë largu shumica prej punës.

Adem Vokshi: Të tregoj drejtën, une kom pasë ni mori rastesh edhe të minatorëve edhe të punëtorëve të Trepçës edhe punëtorëve të Qendrës Medicinale edhe të Komunës, ku i kanë largu prej punës. Më kujtohen mjekët për 3 shtatorin që i kanë largu prej punës atëherë në të '90-ën për kurgjo hiç. Vetëm se me 3 shtator s'kanë shku n'punë edhe i kanë largu prej punës. Sepse ishte qëllimi me i, ekonomikisht me i shkatërru familjet shqiptare, a din, për mos me gjetë zgjidhje edhe për me ikë përjashta. Por, kjo nuk ka ndiku n'punën time, përveç që kom pasë punë shumë, ma shumë sepse u dashtë me shkru kundërshtime, u dashtë me shkru padina, u dashtë me i përfaqësu.

Më kujtohet i përfaqësojsha për marrëdhanie pune, po i përfaqësojsha edhe për çashtje banesore sepse ua kërkojshin edhe banesat me ua marrë. Sepse atëherë nuk kishte pronësi banesore, po kishte vetëm t'drejtë banesore. Pronësi banesore mbas vitit '90 kur erdh ligji për me i privatizu banesat. Atëherë shumica e shqiptarëve nuk ishin n'punë edhe ishte shumë problem me i privatizu banesat. E unë m'kujtohet shumë me sukses i kom përfaqësu për çashtjen banesore, a për çashtje të marrëdhanies punës, ato landë gati kurrë s'janë krye.

I kanë pat' vendosë nëpër Krallëvë, nëpër Kragujevc, nëpër atë, i kanë pa çu landtë e krejt Kosovës për marrëdhanie pune i patën çu atje. Sepse nuk kishin mbështetje ligjore për ndërprerjen e marrëdhanies të punës edhe përkundër që n'atë kohë e prunë ligjin për marrëdhanië të punës n'rrethana t'veçanta. Sepse me nenin 8 të Ligjit të Punës të Marrëdhanieve të Veçanta ishte parapa që punëtori t'mundet paparalajmrim me iu ndërpre marrëdhania e punës, nëse dy apo më shumë ditë pandërpre nuk vjen n'punë. Ishte vetëm ni ditë, 3 shtatori. E për atë ni ditë nuk mujke ligjërisht me ia ndërpre marrëdhanië të punës. Qikjo është ajo.

E për qat' arsye nuk i merrshin qato landë me i shqyrtu fare. Mandej e prunë ni grup të gjykatësave prej Serbisë e Vojvodinës atje me i ndihmu gjyqësorit të Kosovës për me i kry ato landë edhe ata që erdhën asnjani nuk krynte ku me ditë çfarë landë. Shumë, shumë rrallë. Ka pasë nja dy-tre gjykatësa që kryjshin, u mundojshin me kry, por shumë vështirë ishte deri te realizimi i atyre kërkesave.

Anita Susuri: Gjatë viteve të '90-a edhe, janë vra edhe avokatë, kanë qenë për shembull, Bajram Kelmendi u vra...

Adem Vokshi: '99-ën u vra Bajram Kelmendi. Mikel Marku që thashë u vra mbas babës sim... nuk e kanë vra Mikel Markun, ni kojshi serb polic e ka rrafë, qaq shumë e ka rrafë edhe e kanë çu në polici edhe aty e kanë majtë për katër-pesë ditë derisa vdiq ai. Kjo ka qenë.

Anita Susuri: A e keni ndje ju rrezikun apo qysh ju ka gjetë kjo periudhë n'qat aspekt? Domethonë, kur filloi domethonë '98-ën fillimisht me familjen Jashari që u bo masakra, pastaj deri me fillimin e bombardimeve që u vra Bajram Kelmendi, qysh ka qenë krejt kjo periudhë? Pastaj edhe lufta? Po mendoj, reagimi.

Adem Vokshi: Ni, ni, shok i jem e përshkrun kështu, tha, “Ishim pramje”, tha, “gjysa e kafes ishin policë, gjysa ishim kështu edhe luajshim me gurë e pijshim e krejt”, tha, “Edhe po ma bon njani”, tha, “Kqyre”, tha, “po kallet atje Ukrashtica”, edhe “Çka ka me bo une që po kallet atje? Unë s’muj me nimu” (buzëqeshë). Kjo është ajo. Edhe me tregu edhe ni send, nuk e di po jo une, por as bashkëshortja ime, as fëmitë e mi, edhe pse kanë qenë t’vegjël atëherë, nuk jena friku fare. Une i përmbahem atij parimi që ka thanë ai plaku, “Fmi, po ju lo amanet me babën, njiqind herë jom deké dej sot, veç ni herë po diska. Qitash ka ardhë momenti për me deké a. Eh, mos vdisni njiqind here”. Edhe unë njiqind herë s’jom deké, veç niherë kom me vdekë. S’e di a po kuptoni a jo.

A din pse? Tash ju tregoj një... isha n’kompjuter t’u punu, diku ishte ora 1:00, 1:30 e natës, janari i ‘99-ës, ose frori, besa mundet me qenë frori. S’po m’kujtohet tamon. 1:30 e natës kur dera *tak, tak, tak* {onomatope} dera e oborrit, atëherë isha n’shpi.

Anita Susuri: Në Prishtinë?

Adem Vokshi: Jo, në Mitrovicë.

Anita Susuri: Aha.

Adem Vokshi: Po, isha n’shpi edhe kojshi e kisha vllaun e Lah Nimanit, Mustafë Nimanin, vllaun e tina. Ai e kishte dy katë shtëpinë edhe kishte dritare përjashta. Une s’kisha, a po kupton? Edhe po e thirri n’telefon, “Mustafë, a të çova?” Tha, “Po”. I ndjeri ka qenë i mrekullueshëm, thashë, “Pashë Zotin kqyr prej dritarës dikush po troket n’derë. Po du me çelë derën se po m’thojnë jonë tre djem t’ri, se bisedova me ta. Mos e kanë policinë mrapa e po m’bojnë telashe”, kurgjo tjetër. Tha, “Mos e çel derën pa t’thanë une”, edhe ai kqyri n’dritare s’ka kërkund veç ata tretë.

Edhe, nejtë, i shtijmë mrena, e çeli derën i shtijmë mrena e i presim mirë. Policia ti e din te gjykata atje naltë që ishte, prej atjehit i kanë lshu ka 12:00 sahati natës. Ata i kanë marrë prej Skenderajit i kanë lshu atje edhe ata rrugës tuj ardhë kanë trokitë një dhetë-pesëmdhetë shpi, “Një dhetë-pesëmdhetë shpija kena trokitë, kush s’na ka çelë derën”. Kjo është ajo frika a e njerëzve. Mandej m’tregojshin, “E kena ndi valla derën po s’kena guxu me çelë”. Une guxova. Nejtë, e kisha edhe atë kojshinë po edhe mos me pasë pasë ata, une e kisha çelë. Por, meqenëse e kisha këtë zgjidhje pse mos me përdorë ata.

Edhe të nesërmen njoni e kishte një hallë atje në Mitrovicë. Njanin erdh e murrë një profesor i gjimnazit, ka qenë ni Hasan Veliqi. Ai erdh e murrë djalin e vllaut edhe njëni kishte me shku te halla në Vushtrri, por s’guxojke. Thashë, “Une t’çoj me kerr”. E kom hyp n’kerr deri në Vushtrri e kom çu. (qeshë). Qitash një ditë ishte taku njëni prej atyne me djalin tem, njënin prej atyne djemve, edhe i ka tregu çka i ka ndodhë edhe qysh, “Baba yt” tha, “na ka pranë n’shpi atëherë”. Tani na t’nesërmen iu dham edhe sillë edhe i përcillëm kadale. Kjo ka qenë ajo atmosfera e njerëzve po edhe mosfrika ime.

Vetëm ni send mandej jom frigu gjatë '99-ës, kur, jom frigu për fëmijtë e mi. Pse u bona qaq budallë t'u mendu që kjo punë për tri-katër ditë edhe a e pranon kapitullimin edhe zgjidhet ky problem. Jo une, shumë njerëz kanë mendu kështu. E që bohet 77 ditë as ndërmend s'më ka marrë. Ni muj ditë jom cillë nëpër Mitrovicë mshefu ktu, mshefu aty, mshefu aty me familje katër anëtarëshe, kijamet. Qikjo është ajo. Shumë shumë vështirë ka qenë.

Anita Susuri: Çka keni pa gjatë këtyre ditëve që nëpër Mitrovicë jeni end? Çka keni pa, a qysh ka qenë?

Adem Vokshi: Ditën e bombardimeve, atë natë, kazerma ka qenë shumë afër. Mandej kur ka ra atje granata edhe fëmija kanë qenë te kojshia, e kanë kapërcy murin janë hi n'shpi te na. E mandej të nesrit proma kena shku te kojshia atje edhe... po, po kallet shpija e kojshisë edhe unë p'i thirri vatrogascat [Srb.: zjarrfikësit] s'po lajmërohen. Pe i thirri policinë, p'i thom, "Qishtu qishtu po kallet shpija", tha, "Edhe shpija jem po kallet", "M'falni", çka m'i bo. Po neve s'na ngucën aty n'shpi. Të nesërmen kom hypë n'kerr edhe i kom marrë familjen edhe jom nisë kah Zubinpotoku n'atë anë.

M'ka dalë policia tha, "Ku kështu?" Thashë, "Nëse Zoti jep deri në Veli Breg me shku", s'po ju tregoj ma larg, "Kthehu! Kthehu, po t'thom!" S'la as me folë, se me folë serbisht ia mujsha, a din. Por, çka me folë, u ktheva (qeshë). Jom mshefë te motra e këtij Mustafës, ni natë veç e kena bo ni gjum. Krejt shpijat rreth janë kallë atje, krejt shpijat janë kallë, dugojt u kallën krejt, krejt, kijamet u konë. Edhe Mustafa ditën... unë me marrë do bujashka atje, m'i marrë do patate atje, se s'kish bukë as kurgjo e m'i pjek.

Edhe tash kur dy policë hyn i thyen dyrtë atje t'oborrit edhe hyjnë brenda unë e kisha kerrin aty, ni Kadet e kom pasë. Edhe tha, "Kush o ktu?" Thashë, "Une me familjen teme". Tash, për Mustafën s'po guxoj me tregu se ai dul atje ish mshef dikah. Po me tregu që është ai, pse u mshef atje? Me gjetë ata e vrainë, nejse (qeshë). Ata me automata. "Kush o brenda?" "Familja jeme", nejse hyn brenda i kqyri atje edhe dulën përjashtë. Kur dulën thashë, "A po doni n'podrum me kqyrë?" Thanë, "Ja ja ty po t'besojmë".

Po katër kenë, dy përjashta mbetën dy mrenda. Edhe njani po ma bon, "Kush je ti?" Thashë, "Une jom Adem Vokshi", çka me thanë. Ata m'njofin ma mirë. Ai po ia bon, "Avokat i njoftun", ky po ia bon, "A u kanë i mirë a jo?" (qeshë). "A po ma shet kerrin?" Thashë, "Jo", "Pse?" Thashë, "Kqyre more podi qysh e ka lshu krejt". Përnime ishte i dëmtum shumë, "E ka lshu shumë e me bo me ta shitë kështu thu kqyre avokati m'mashtroi. Mos bo hajgare!" Thashë, "Po s'të ka hije", thashë, "se të lshon 200 kilometra s'munesh m'i gra".

E mandej u pajtu se kur i thashë jo {shpjegon me duar} (qeshë). Dulën, mbasdite erdhën dy serbë tjerë edhe ata me maska erdhën. Këta paradite pa maska, masdite me maska. "Kond e ki aty?" Thashë, "E kom pronarin e shpisë edhe une jom me familje krejt", edhe hin brenda. Kontrollunë me automata krejt kështu {shpjegon me duar}. Po kur t'u dalë përjashta po ma bon njani, unë e njifsha ata po

s'guxojsha me i thanë që po e njoh. Ai perfekt shqipën. Tha, "Mos të shoh ma ktu", serbisht. A kuptoni serbisht? [i drejtohet intervistuesës].

Anita Susuri: Po.

Adem Vokshi: Nejse, thashë, "U bo. Ku me shku?" Tha, "Për Shqipni". Thashë, "Sonte?" "Jo, jo", tha, "nesër". "U bo, faleminderit!" Atë natë gjithë shpijat rreth e rreth u kallshin a. Ne aty n'shpi as gjumë s'mujshim me bo. Të nesërmit prej aty me kerr e në pjesë veriore se knej s'guxojsha me shku. Në pjesë veriore e kisha çelsin e banesës të çikës të axhës atje kojshi me SUP-in (qeshë). Qaty kom ndejtë nja katër-pesë ditë, mandej edhe prej atyhit ma kishin vjedhë kerrin, mandej prej atyhit kom dalë n'kamë poshtë. Kena dalë në stacion të autobusave me u mundu me shku, po atë ditë u bombardu ajo ura t'u shku kah Zubinpotoku n'atë anë edhe nuk mujtëm me shku. Edhe mbas katër-pesë dite, mandej në kolonë e për Shqipëri.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo se është goxha larg?

Adem Vokshi: Kom pasë fatin, s'po di, ndoshta ndoshta unë besoj shumë Zotin edhe t'u bo mirë edhe gjen mirë. Ni natë kom bujtë me familje atje në Zhabor edhe të nesrit na kanë përzanë ushtria në 12:00 sahati ushtria e rregullt, "Hajde, leni, me shku në stacion të autobusave". Jena ndalë te shkolla në Shipol atje, edhe aty kena ndejtë atë natë. E kena gjetë ni shpi, po shyqyr që e gjetëm se filloi shi, kijamet shi. Edhe t'nesërmit shkoi njani prej atyne ku flejtëm atje ia ka dhanë nja 200 marka atij policit edhe ia kish dhanë jo kamionin e mirë, atë tjetrin ia kish dhanë. E në qat kamion m'kanë fut mu n'fund atje, "Mos t'shohin ty, se ty t'bojnë telashe". Fëmi, gra kha përpara deri tre kilometra para kufinit na ka çu qai kamion.

Rrugës e ndalën te Prroni i Keq atje e dënnun nja 70 marka, e dënnun demek tonë kta njerëz i ke hipë e qisi sende. Po kalum mirë, kalum. Tani n'komë jemi ardhë deri n'kufi. Tani n'kufi, kufini mbyllun deri në ora 9:00. Në ora 9:00 ka fillu shi, kijameti i Zotit, ledinë. Nuk guxonim me marrë tesha, nuk guxonim kështu, nuk guxonim ashtu. Hajde faqja zezë. Dokumentat e shpisë edhe krejt, letërnjoftimin krejt ato, njanit prej bineqve, ai s'din serbisht, ia shtina ktu n'bark edhe thashë, "Hiç mos fol. Nëse të ndalin une jom ktu, une foli me to".

Kur filloi shi qashtu, fillunë me kalu kufinin ata, "Dokumentat?" Nja dy kojshike t'mija po ia jepin letërnjoftimin, ja morën ia çkynë {shpjegon me duar}, a din. "Dokumentat ti?" Thashë, "Krejt i kanë marrë rrugës". "Hajde, kalo!" Po, kurgjo, i pshtova dokumentat. Nejse e pshtova familjen e që ishte shumë mirë. Thojsha me këto mend t'u ditë gjithçka edhe qysh u habita me mbetë ktu. Krejt ata shoktë e mi, "A don me ikë?" "Jo more, çfarti, pse me ikë?" Kur t'nesërit kërkund s'janë ata, janë ikë para meje (qeshë).

Anita Susuri: E në Shqipni ku keni qëndru?

Adem Vokshi: Kom qëndru në Tiranë. Natën e parë kom qëndru te ni mitrovicali atje te banesat e arabëve edhe t'nesërmen... nejtse, atë natë jena mundu me kontaktu me familjen e grusë, se familja e grusë e ka shpinë në Tiranë, në qendër, te Fakulteti Juridik atje. Po na nuk e dishim, as nuk dishim qysh me shku. Nashti njiqind frikë që s'ju pranojnë në Tiranë, s'ju pranojnë në Durrës, ju çojnë në Vlorë e çka po di une. Edhe të nesërmen jena dalë me ecë qashtu, por, pa, pa... edhe jena taku me ni akraba t'nusës edhe na ka tregu, na ka orientu atje edhe kena shku atje. Nja dy-tri ditë kena nejt atje, tana kena gjetë ni banesë me qira dy dhomëshe 600 marka në Tiranë edhe për dy muj ditë përneherë kemi pagu edhe qashtu (qeshë), çka me bo.

Anita Susuri: Qysh e keni pritë lajmin për çlirimin edhe qysh jeni kthy? Ku jeni kthy?

Adem Vokshi: Është shumë interesant. Qiky djali që punon me mu, Urimi, ishte i vogël atëherë, gjashtë vjet, as gjashtë vjet të plota. Kur kemi dalë kah Shqipnia që e kalum kufinin atje, "Babi", tha, "flamuri" "Po, me babin", thashë, "Na u ka kajt nana". M'u kujtun palestinezët, m'u kujtun muhaxherët shqiptarë, e krejt ato m'u kujtun. "Kurrë s'kena m'u kthy ma knej". Diçka e pabesueshme! E tani ankohen, veç lirinë me pasë. Shkova në Novi Pazar '98-ën me ni shok atje ma bojshin ata boshnjakët, "Çka po doni ktu? Tona t'mirat, kerre keni, kta keni, kta keni... çka po lypni tjetër?" "Lirinë p'e lypim". Pa liri krejt shkunë.

Anita Susuri: Qysh jeni rimëkëmbë pastaj? Qysh keni fillu me punën?

Adem Vokshi: Në Pejë krejt çka kom pasë janë kanë t'shkatërrume. Nejtse, jo t'mijat po shpija e përbashkët ka qenë. Në Mitrovicë ni shpi që e kom pasë e kom pasë n'podrum ma kanë shti kta vllaznit e Adem Demaçit, une ngucna kanihere. E zyrën ma kanë shkatërru, prej nja 13 mijë landëve më kanë mbetë nja 300-350 landë, jo komplet po që i kom gjetë a din, që i kanë shkatërru. Ato literaturë e libra e kom pasë kijamet, krejt m'i kanë marrë. E mandej ato i kom shti n'kompjuter mos po i vyn dikujt prej palëve edhe kanë ardhë i kanë marrë disa çka ka pasë atje.

E kom ndejtë ni natë te ni shok në Mitrovicë, mandej mas dy dite kur u ktheva prej Pejës nuk kishte vend ma aty edhe kom ndejtë te ni shok tjetër në Mitrovicë. Ai me zor m'ka marrë atje, po nuk kom ndejtë tre-katër ditë. Edhe mandej ni gjakovar i vjetër, ni Arsim Abrashi ma ka dhanë ni banesë t'cilën unë ia kom fitu kur ia kanë ekspropriu pasurinë. Jo atë banesë, nja tri banesa, shpi e krejt ato. Po ai, "Merre kta edhe", {shpjegon me duar}. Mujke me lshu me qira në qendër të Mitrovicës, bash përballë me komunën. Tha, "Ti ni vjet ktu me ndejtë".

Edhe mandej ni vjet tjetër qitij Mustafës, kojshisë tem ia rregullova përmes AKTED⁷-it ka qenë atëhere me rregullu shpinë që e ka pasë kategoria e katërt. Unë e kom pasë kategoria e pestë, a din prej fillimit është dashtë. Atij ia rregullun ata e aty kom banu ni vjet. Mandej e kom ble ni shpi t'vjetër, kijamet e

⁷ Agency for Technical Cooperation and Development (ACTED) - Agjencia për Bashkëpunim dhe Zhvillim Teknik.

kom ble. Që kur e kom ble kur ka ndëgju gruja jeme cilën shpi e kom ble ka thanë, “Ti s’je normal”, çka me bo? Thashë, “Une kom me rregullu atë shpi edhe ju s’keni me hy aty”, edhe njoni prej bineqve ma boni qata edhe po tha, “Qysh mos me ble? Me tre mijë marka a blehet shpija?”

E kom pa shitë pllacin mandej se ajo gruja që ma shiti ishte gruaja e një shokut tim, katolik ka qenë ai. Une kom pasë shumë muhabet me to, e mandej kjo u martu në Pejë po na ka pat’ mbetë muhabeti se ai vdiq, ai shoku jem, e gjithmonë i kena rujtë ato raporte. Njanin djalë e kishte në Amerikë, çikën e kishte t’martume Posturc a, e kishte t’martume në Kroaci, në Zagreb.

E tha, “Po m’jepin njëqind mijë euro”, ajo shpi, njëqind mijë marka, shpija u shitke shumë kohë t’gjatë po s’ishte kader [fat]. Ka qenë e rujtne për mu (qeshë). Edhe tha, “Për njëqind mijë po ta jep ty se gjynah është ti nëpër rrugë me mbetë”, a din, thashë, “O faleminderit shumë, po une pare s’kom”, tha, “Bone veç ni t’treten çikës po i vyn, djalit”, tha, “E mu, kur t’bon pare m’i jep”, “A qashtu a?” “Po”. “Boma përhapër”. I kom nxjerrë qato tre mijë marka ia kom dhanë. Me qato tre mijë marka kom ble shpi. Po mandej kadal dale jom rehabilitu.

M’kanë lutë me u bo gjykatës mbas luftës menihere. Kanë dëgju, jurist i mirë e ke qenë gjykatës e qishtu me i ndihmu kësaj popullatës. Po bre ka qenë një hajnere atje thashë, “A po m’tregon diçka?” Thashë, “Rrogën 250 marka. Po?” Thashë, edhe po i tregoj çka kom hupë krejt, çka kom trashëgu, çka kom fitu. Gruaja intelektuale, une intelektual e krejt. Thashë, “Edhe me 250 marka kur muj me u rehabilitu?” Thashë, “A ka rrezik me qenë une avokat? Mos o e ndalume?” “Jo, jo”, tha, “mundesh me qenë”. Thashë, “Une p’e zgjedhi avokaturën, e kom zgjedhë krejt edhe në avokaturë po rri”.

Edhe në fund une jom i martum. E kom grunë e Pejës se krejt mendojnë që e kom grunë e Mitrovicës, po ato të Mitrovicës n’kohën time s’më kanë dashtë, po e kom mashtru kta ka qenë studente edhe jom martu me to. Edhe i kom dy bineq ‘85-tën t’lindun, e kom vajzën ‘89-tën t’lindun edhe djalin e vogël ‘93-tën t’lindun. Djali i vogël punon me mu avokat, njëri prej bineqve është avokat, por është në Mitrovicë. Ai tjetri binak është në ekonomik punon në Prokurori në Mitrovicë, po ka edhe ni dyqan privat që merret me to.

Vajzën e kom ekonomiste, ka magjistru në Fakultetin Ekonomik. Për momentin është zëvendës drejtoreshë në shkollën “Mehmet Akif” në Lipjan edhe e ka ni vajzë, ajo edhe pret edhe ni fmi tjetër. Djali i madh i ka dy vajza edhe ni djalë. Djali i dytë, ai binaku i ka dy djem. Shumë të parahatshëm, po çka me bo, fmi. Ky djali i vogël e ka ni vajzë tash shumë shpejt edhe qishtu. Ni familje e mirë e dobishme për shoqinë.

Anita Susuri: Tash jeton në Prishtinë apo?

Adem Vokshi: Jo, në Mitrovicë ende jetoj, se gruja s’po m’vjen në Prishtinë (qeshë).

Anita Susuri: Korab, a ki ndonjë pyetje?

Korab Krasniqi: Po, si fundi me qenë. Meqenëse e keni përjetu, si me thanë, disa sisteme, po e quj sisteme, mandej '90-ta regjimin e Millosheviqit edhe tash po jetoni në Kosovë t'pavarur e cila po mundohet me ndërtu shtetin me kapacitetet që i ka edhe ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare. Me t'pytë, qysh i ke pa ose qysh mundësh me i krahasu kto tri sisteme t'drejtësisë?

Adem Vokshi: Asnjëni prej sistemeve nuk m'ka pëlqy. Tjetër është që kam qenë i detyrum me jetu n'ato sisteme. Sepse sistemet e mëparshme kanë qenë despotike, kanë qenë sisteme që kanë mendu me komandu me njerëzit, kanë qenë sisteme... edhe sistemi socialist që i ka bo njerëzit e mvarun prej t'ardhunave, ni rrogë e ki edhe e ki pushimin n'deti me shku dhetë ditë edhe eventualisht ni vikendicë, po.

Ky sistemi tani që osht' edhe ky i ka dobësitë e veta. Por, shiqoni krahasoni Kosovën e '99-tes e '98-tes, mos t'thom ma herët, me Kosovën e sotit, a nuk kena ndryshim? Po lakmojnë rinia me shku përjashta, çka gjejnë përjashta? Une kom mujtë kaheerë me shku përjashta. Atëherë kur ma kanë vra babën, me dy durë m'kishin prit përjashta edhe për fmi edhe për krejt. Po mbarojnë shpija ktu dy katëshe, tri katëshe për fmitë. Ai vet s'ka me u kthy le mo fmija me ju kthy a.

Është Kosova e mrekullueshme, është e lirë. Tani veç duhet me punu edhe me i zgjidhë njerëzit që vyjnë nëpër kto pozita. E kena pa që disa po zgjidhën që nuk vlejnë, zgidhi ata që janë ma t'mirë. Qikjo është ajo. Me tona t'mirat jena. Me tonat.

Anita Susuri: A ki mo pyetje? [i drejtohet Korabit] Faleminderit shumë për intervistën edhe për kontributin e ju.

Adem Vokshi: Faleminderit edhe juve për krejt punën që po e boni edhe krejt angazhimin edhe krejt kto, po shpresoj që sukse si nuk do t'ju mungoj.

Anita Susuri: Faleminderit shumë.

Korab Krasniqi: Faleminderit.